mesatare vjetore jane shume me te larta krahasuar me rajonet e tjera dhe mundesite e shfrytezimit te energjise elektrike jane me te medhaja.

Pasqyra 13. Shpeshtesia e perdorimit te druve te zjarrit sipas rretheve perfaqesuese (%)

Rrethi	Shkalla e perdorimit (ne%)					
	Gjithnje	Disa here ne dite	1 here ne dite	Rralle	Kemi por nuk i perdorim	Nuk e perdor pasi s'kemi dru zjarri
Has (30 intervista)	0.0	9.3	3.9	1.5	0.0	0.0
Bulqize (30 intervista)	0.0	3.9	7.8	2.4	0.0	0.5
Kruje (30 intervista)	7.8	3.4	1.5	1.0	0.0	1.0
Berat (30 intervista)	10.2	1.5	1.5	0.5	1.0	0.0
Durres (30 intervista)	0.0	8.8	2.9	1.0	0.5	1.5
Devoll (30 intervista)	9.8	2.4	0.0	0.0	0.0	0.0
Delvine (25 intervista)	3.9	3.9	1.5	0.0	5.4	0.0
<b>% e Grupit ndaj Totalit</b>	<b>31.7</b>	<b>33.2</b>	<b>19</b>	<b>6.3</b>	<b>6.8</b>	<b>3</b>
<b>Totali i Intervistave</b>	<b>65</b>	<b>68</b>	<b>39</b>	<b>13</b>	<b>14</b>	<b>6</b>

Duket qe rajoni i Durresit i perket te gjitha niveleve te perdorimit te druve te zjarrit, kjo si rezultat i migracionit te brendshem (cvendosjet nga veri-lindja drejt metropolit shqiptar Tirane-Durres-Kavaje), kosmos me te larte te jeteses dhe pamundesise per te siguruar dru zjarri me kosto te lire ose falas/(ilegalisht) dhe rrallesise relative te burimeve pyjore.

### 2.3.3 Binomi Varferia dhe Pylli: Pergjithesime dhe Fakte nga Realiteti Shqiptar

Ashtu sic kane konkluduar dhe nga disa studime te tjera te bera nga D.Sh.K.E si dhe institucione, OJF dhe agjensi te tjera publike dhe private, varferia ne Shqiperi eshte\*ne nivele relativisht te larta, per shkak te mundesive te kufizuara per pune dhe si rrjedhim i te ardhurave te ulta, kryesisht ne degen e bujqesise (mjedisi rural).

Shkalla e varferise ne vendin tone nuk shfaqet vetem ne nivelin e ulet te te ardhurave mujore familjare dhe/ose te konsumit te te mirave materiale/ushqimore, por dhe ne drejtime te tjera si:

- cilesi e dobet e sherbimeve baze publike (arsim, shendetsi, etj.)
- dallime te theksuara midis zonave urbane dhe atyre rurale,
- paqendrueshmeri relative politike,
- shkalle e larte e migrimit te brendshem dhe atij te jashtem, si dhe
- theksimi i fenomeneve negative sociale ne drejtim te:
  - ◇ thellimit te diferencave ne treguesit baze social;
  - ◇ ndryshimet demografike te familjes tradicionale shqiptare;
  - ◇ korrupsionit dhe ekonomise informale etj.

Vrojtimet e meparshme (1996) kane treguar se varferia ne Shqiperi eshte nje fenomen i pergjithshem, por sidomos rural, pasi rreth 90% e te varferve jetonin ne zonat rurale dhe 60% e kryefamiljareve te familjeve te varfera jane te vete-punesuar ne bujqesi\*.

Bazuar ne mjaft artikuj dhe shkrime te fushes ekonomike (si p.sh. Gazeta "Ekonomia"), mbi 780 mije njerez (600 mije njerez ne fshat dhe 185 mije ne qytet) ose rreth 1/4 e

\* Dokumenti i Ndermjetem i Strategjise per Pakesimine Varferise ne Shqiperi (Maj 2000).

popullsise jetojne ne kushte mjaft te veshtira varferie. Me nje fjale, rreth 30% e popullsise se zonave rurale dhe rreth 15% e popullsise te atyre urbane ndodhen ne varferi relative, ne krahasim me pjesen tjeter te popullsise.

Duke u mbeshtetur tek i njeiti burim, 10 perqindeshi me i varfer i kesaj popullsie jeton me te ardhurat bujqesore prej me pak se 70 USD ne vit/fryme dhe nuk eshte ne gjendje te siguroje ushqimin baze per gjithe vitin.

Bazuar ne te dhenat e vrojtimit te ndermarre nga Q.Sh.K.E ne kuadrin e ketij studimi del qe rreth gjysma (50.2%, shih Pasqyra 12) e familjeve rurale jetojne me nje nivel te ardhurash deri ne 10,000 leke ne muaj (perfshire ne kete shifer dhe vlere e produkteve bujqesore/blegtorale). Niveli i varferise eshte me i larte ne veri te Shqiperise ku 51.2% e familjeve qe zoterojne ferma me madhesi shume te vogel 0-dhe pjellori te kufizuar (0.5 ha toke) jetojne ne fshatrat veriore.

Duke iu referuar te dhenave te meposhtme shohim se familjet e varfera jane pergjithesisht familjet me nje apo dy femije nen moshen 18 vjec. Kjo do te thote se familjet e varfera jane familjet e sapo krijuara me nje moshe mesatare te re, familje te cilat duhet te perballojne volumin me te madh te puneve te fermes nga prinderit. Me tej duket qarte se keto familje nuk mund te perfitojne as dhe nga te ardhurat e mundshme si rezultat i emigracionit te kalamajve te tyre jashte vendit apo ne zonat urbane (pasi kalamajte jane akoma te vegjel dhe jo ne moshen efektive te punes).

Te dhena me te detajuara jepen ne pasqyren e meposhtme:

Pasqyra 14. Te ardhurat mujore sipas numrit te femijeve ne familje

Numri i femijeve ne familje (<18 vjec)	Te ardhura mujore per familje (ne leke) *						Gjithsej
	Deri ne 2,000	2,001- 8,300	8,301- 18,000	18,001- 31,000	Mbi 31,000	Pa pergjigje	
	Familje (ne numer)						
1	0	9	13	2	4	4	32
2	5	13	19	11	2	7	57
3	4	10	11	1	0	1	27
4	1	5	5	0	0	0	11
5	0	1	0	0	0	0	1
>5	0	0	0	0	0	0	0
Asnje <18 vjec	5	29	28	5	0	0	76
Pa pergjigje	0	0	1	0	0	9	76
<b>Totali i Intervistave</b>	<b>15</b>	<b>67</b>	<b>77</b>	<b>19</b>	<b>6</b>	<b>0</b>	<b>1</b>
<b>Grupi ndaj Totalit (%)</b>	<b>7.3</b>	<b>32.7</b>	<b>37.6</b>	<b>9.3</b>	<b>2.9</b>	<b>10.2</b>	<b>100.0</b>

Korrelacioni i larte negativ, qe njihet ne pergjithesi midis varferise dhe nivelit te ulet arsimor, vertetohet edhe nga shifrat e nxjerra prej studimit tone. Keshtu, rreth 73% te familjeve qe kane nje nivel te ardhurash mujore deri ne 10,000 leke, e perbejne ato me arsim fillor dhe tetevjeçar.

Pasqyra 15. Te ardhurat mujore sipas nivelit arsimor te familjeve

Niveli arsimor i familjeve	Te ardhura mujore per familje (ne leke)						Gjithsej
	Deri ne 2,000	2,001- 8,300	8,301- 18,000	18,001- 31,000	Mbi 31,000	Pa pergjigje	
	0						

	Familje (ne numer)						
Fillor	3	22	5	1	0	2	33
8-vjecar	10	40	23	9	2	10	94
I mesem	1	23	25	8	2	6	65
I larte	0	0	3	1	2	0	6
Pas universitar	0	0	0	0	0	0	0
Pa arsim	1	3	0	0	0	3	7
<b>Totali i Intervistave</b>	<b>15</b>	<b>88</b>	<b>56</b>	<b>19</b>	<b>6</b>	<b>21</b>	<b>205</b>
<b>Grupi ndaj Totalit (%)</b>	<b>7,3</b>	<b>43</b>	<b>27,3</b>	<b>9,3</b>	<b>2,9</b>	<b>10,2</b>	<b>100</b>

I ndodhur ne te tilla kushte, fermeri shqiptar mundohet te siguroje ato burime natyrore, te cilat kane nje kosto relativisht te ulet (per te mos thene pa kosto fare), nga te cilat nxjerr nje dobi/kenaqesi te mjaftueshme per ate nivel te nevojave baze familjare qe ai percepton. Nje nder burimet natyrore qe ploteson keto kerkesa eshte partneri i te gjitha koherave te njeriut, pylli, qe ne rastin e vendit tone ze rreth 36% te siperfaqes se Republikes.

Me privatizimin e tokes bujqesore dhe tendencen gjithnje e ne rritje per shtim te nensektorit blegtoral, presioni mbi pyjet tona u rrit, sidomos ne zonat rurale, jo vetem per plotesimin e nevojave lokale, por edhe per interesa fitimi-pruresore. Kjo pasuri kombetare natyrore vazhdon te mbetet e nenvlefesuar jo vetem nga publiku i gjere, por edhe nga "pronaret" dhe autoritetet rregullatore, per rrjedhoje do te vazhdohet te keqperdorohet.

Nga pikpamja teknike, pyjet kane dy funksione: mbrojtjes dhe prodhues. Si rrjedhoje, percaktimi i vleres monetare te sherbimeve mbrojtese dhe nrbareshtruese te pyllit eshte shume here me i veshtire sesa perlllogaritja e vleres te produkteve pyjore (derrase, etj). Ne rastin e vendit tone pyjet ne pergjithesi jane shfrytezuar sikur te kishin vlere vetem dy gjera: tokat bujqesore, te menduara "nen pyll" (pervoja para '90) dhe lenda drusore "mbi pyll" (pas '90).

Shume analiste ekonomiko-financiare te sektorit pyjor theksojne qe, kur analizohet nje qellim ekonomik

*dikush duhet te shenoje jo vetem rezultatet e menjehershme, por edhe rezultatet ne periudhen afatgjate, jo vetem pasojat paresore, por edhe pasojat dytesore dhe, jo vetem efektet ne disa grupe te vecanta, por efektet tek secili.*

Deshtimi ne zbatimin apo marrjen parasysh te ketij konkluzione mbase eshte burimi me i zakonshem i gabimit qe ndokush mund te beje kur analizon efektivitetin ekonomiko-financiar te ekonomise pyjore.

Mesazhi kryesor i shprehjes se lartpermendur eshte se shfrytezimi i nje burimi, aktualisht me nje kosto te vogel, deri ne ate mase sa te luaj perseri rolin e tij funksionues per brezat e ardhshem, d.m.th pa u transformuar ne nje burim, qe gjeneron vetem kosto per te tjeret.

Ne kete kontekst nuk duhet te anashkalohet pervoja e shfrytezimit te burimeve pyjore pas vitit 1990 per te cilen, ne pergjithesi, eshte krijuar pershtypja sikur ajo eshte me e hidhura.

Mbrojtesve te ketij mendimi do t'u kujtojme se para '90-es shfrytezimi pyjor, vecanerisht per drute e zjarrit, ishte sa dyfishi i mundesive vjetore te ketij shfrytezimi (priteshin 1,4-1,5 milione m<sup>3</sup> dru zjarri nga 700-800 mije qe ishin mundesite). Kjo si dhe prerjet per qellime te tjera pas vitit 90 jane pakesuar dukshem.

Sot:

- banoret urbane perdorin shume pak dru zjarri;
- trare per miniera nuk priten me (shumica e minierave nuk funksionojne);
- ndertimet e reja, pergjithesisht, nuk perdorin skela druri, ose material drusor per dyer e dritare etj.

Por, pas vitit '90, faktore qe i shtyjne njerezit te arrijne ne konkluzionin e nxituar se "pyjet po shfarosen" jane disa:

- **Arsye e pare** eshte fakti se lenda drusore eshte prere ne parcelat e ekonomive pyjore prane rrugeve auto, ku dhe kalimtarit te thjeshte i bien menjehere ne sy prerjet e druve.
- **Arsye dyte** eshte menyra e prerjes te lendes drusore dhe e terheqjes te rregullt te ketij materiali nga pylli nga shfrytezuesi, qe ne me te shumten e rasteve eshte ilegal. Ky shfrytezues nga frika per te mos u zene nga personeli pyjor, nuk zbaton kriteret teknike te prerjes se druve ose nuk arrin ta terheq nga pylli materialin drusor te prere, duke lene keshtu te vezhguesi i thjeshte pershtypjen e nje masakre te vertete ne pyje.
- **Arsye e trete** ka te beje edhe me devijimin e sektorit pyjor nga ligjet dhe parimet e ekonomise se tregut te lire, te cilat lidhen me politikat e gabuara qeveritare per tregjet, duke caktuar cmime te papershtatshme per burimet natyrore.

### 2.3.4 Madhesia e Njesive Ekonomike Bujqesore

Gjate sistemit te socialist, ku mbizoteronte planifikimi i centralizuar i ekonomise, toka e punueshme ishte prone e shtetit, ne te cilen ndermarrjet bujqesore shteterore dhe kooperativat bujqesore perbenin njesite me te medhaja, te pajisura me agregate bujqesore te nevojshme. Me miratimin e ligjit te tokes (19 Korrik 1991) toka e punueshme (ne shfrytezim nga kooperativat dhe shteti) iu shpernda ish punonjesve te njesive te lartpermendura. Prej ndarje se tokes perfituan rreth 400 mije-familje ne shkalle vendi dhe madhesia mesatare e n.j.e.b. arrinte nga 1-1.5 ha.

Pas gezimit te marrjes se tokes, bujku shqiptar u perball me shume veshtiresi, nder te cilat mund te permendim: mungesen e kapitalit dhe te mekanikes bujqesore, copezimin e madh te tokes, krizen industriale te shoqeruar me mungesen e plehrave, pesticideve dhe shume mungesa te tjera madje dhe me ligjin e ndarjes se tokes, ku nuk percaktohej nese toka mund te shitej apo te jepej me qira.

Ketyre veshtiresive iu shtua dhe pretendimi i ish-pronareve te vjeter te tokave, gje qe solli probleme, te cilat vazhdojne te jene dhe sot.<sup>3</sup> Nga ana tjeter, hyrja ne Shqiperi e shume produkteve bujqesore nga vendet fqinje e gjeti te papergatitur e te pambrojtur punonjesin e nj.e.b. shqiptare. Ne keto rrethane, shume prej forcave te punes te ketyre njesive bujqesore i kthyen syte nga emigracioni, duke punuar ne feramat e me pune te tjera te vendeve fqinje. Per rrjedhoje nje pjese e tokave ne vendin tone u trasformuan ne toka djerre apo te abandonuara (qe u konvertuan natyralisht ne livadhe apo kullota te varfera).

Bazuar ne rezultatet e vrojtimit, 41.4 % e familjeve te nj.e.b. zoterojne nga 0.6-1 ha toke; 21 % kane ne zoterim nje siperfaqe toke e cila shkon nga 0-0.5 ha. Familjet me 1.1-1.5 ha toke perbejne 20% te totalit, nderkohe qe, vetem 0.5% e familjeve te nj.e.b. zoterojne nje siperfaqe toke nga 3.1-3.5 ha, te cilat i perkasin zonave fushore ne jug dhe jug-lindje te vendit.

### ???KOMENT PER IVISIN: SA NDRYSHOJNE KETO PERQINDJE NE KRAHASIM ME ATO TE STRATEGJISE SE RRIJES EKONOMIKE???

Pasqyra 16. Madhesia e siperfaqes se tokes ne zoterim nga njesite ekonomike bujqesore

Rrethi	Madhesia e siperfaqes se tokes (ha)							Pa pergjigje
	0-0.5	0.6-1	1.1-1.5	1.6-2	2.1-2.5	2.6-3	3.1-3.5	
Numri i familjeve qe e kane ne zoterim								
Has	6	16	5	2	0	0	0	1
Bulqize	7	16	5	0	0	0	0	2
Kruje	9	9	5	2	1	1	1	2
Berat	10	13	3	3	0	1	0	0
Durres	1	11	13	3	1	1	0	0
Devoll	2	10	3	7	0	3	0	0
Delvine	8	10	7	2	0	3	0	0
<b>Totali i Intervistave</b>	<b>43</b>	<b>85</b>	<b>41</b>	<b>19</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>5</b>
<b>Grupi ndaj Totalit (%)</b>	<b>21.0</b>	<b>41.4</b>	<b>20.0</b>	<b>9.3</b>	<b>1.0</b>	<b>4.4</b>	<b>0.5</b>	<b>2.4</b>

Nga studimi eshte nxjerre edhe madhesia e siperfaqes se tokes ne zoterim sipas numrit te frymeve per familje. Por, duke marre parasysh dhe familjet e intervistuar, sasia e tokes ne zoterim sipas frymeve nuk paraqitet shume problematike. **?????? Cfare do te thuash me kete?????** Ne kete veshtrim, gjendja ekonomike e familjeve te nj.e.b. nuk duhet pare vetem ne lidhje me siperfaqen e tokes ne zoterim, por edhe, me faktore te tjere, si: aftesine per shfrytezimin e saj, shkallen e prodhimtarise se tokes (pjelloria), shkallen dhe menytrat e bashkepunimit ndermjet punonjesve te nj.e.b., politikat qeveritare per nxitjen e prodhimit bujqesor te vendit, etj masa.

Prandaj kur studjohet perdorimi optimal i tokes dhe efektet e tij ne ruatjen e burimeve natyrore (perfshire ketu dhe pyjet), problemi duhet te shikohet ne nje kompleksitet me

<sup>3</sup> Nga zbatimimi i reformes per ndarjen e tokes sipas ligjit (rreth 50 mije ha nga ish-sektori shteteror dhe 10 mije ha nga ish-sektori kooperativist (pothuajse ne cdo rreth te vendit tone siperfaqe te vecanta toke u refuzuan per t'i marre ne pronesi apo dhe per t'i perdorur nga punonjesit e te dy sektoreve te bujqesise.

te gjere (dhe jo vetem ne kuadrin e pronesis se tokes si madhesi siperfaqe) duke pershire ketu dhe faktoret qe thame me siper.

### 2.3.5 Prodhimi Blegtoral

Ne strukturen e prodhimit te pergjithshem bujqesor vlere e produktit blegtoral aktualisht ze 50%. Megjithatë demtet e konisderueshme ne bagetite e trasha dhe te imeta pas vitit 1990 (therjet, shitjet gjate kohes se firmave piramidale, shitjet e paligjshme te kafsheve ne vendet fqinje, etj), prodhimi blegtoral ka ardhur gjithnje ne rritje.

Ritmet e shtimit te ketij prodhimi si vlere ne 7 vitet e fundit kane qene mesatarisht cdo vit 7,8% (1992:1999), shifer kjo e kenaqshme, po te mbahet parasysh migrimi i brendshem dhe ai i jashtem i forcave te punes sidhe importimit relativisht te ngadalet te teknilogjise dhe diturise prodhuese nga vendet e zhvilluara drejt Shqiperise. Megjithate, ky sektor i bujqesise ende nuk ploteson nevojat e plota per ushqim te popullates (me perjashtim te disa produkteve ku nder me kryesoret eshte qumeshti dhe mishi, kundrejt te cileve me teper vemendje do perqendruar ne rishperndarjen dhe ne perpunimin industrial), mbeshtetur ne normat ushqimore te FAOs dhe Organizates Boterore te Shendetsise (OBSh). Kete e vertetojne, vec te tjerave, edhe niveli ende i larte i importet te pervitshme i cili stimulohet jo vetem nga cilesia me e mire ( dhe ne disa raste dhe kosto unitare me e ulet se prodhimi vendas) por edhe nga prodhimet gjithvjetore qe eliminojne ciklitetit ne konsumin e artikujve (te perpunuar ose jo) bujqesor dhe blegtoral.

Mbeshtetur ne dokumentat e referuara ne Konferencen Kombetare per Blegtorine (Korrik 1999), sipas te dhenave te raportuar nga Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit (MBU), prodhimi i prprodukteve blegtorale per fryme (per 3 milione banore) rezulton ne rreth 32,6 kg qumesht, 18 kg mish peshe e therur dhe 125 kokrra veze. Zhvillimi i blegtorise dhe rritja e prodhimit blegtoral pergjithesisht mbeshtetet ne rritjen ekstensive dhe ne njesi ekonomike bujqesore me nje numer te caktuar bagetise, gje qe vertetohet jo vetem nga vrojtimet ne kuadrin e ketij studimi, por edhe nga te dhenat e regjistrimit te pergjithshem e njesive bujqesore, si meposhte:

Pasqyra 17. Numri mesatar i krereve per njesi ekonomike bujqesore

**KOMENT PER IVISIN: KETE pasqyre duhet ta kete update ALKETA ku krahasohet niveli i blegtorise se rajonit me shkallen e prerjeve ilegale ne rajon>>**

Rrethi	Llojet e bagetive (krere)			
	Gjedhe		Bageti te imta	
	Ne nivel shembulli	Ne nivel Republike	Ne nivel shembulli	Ne nivel Republike
Has	1.4	2.3	5,9	20,6
Bulqize	1.4	2.0	7,8	12,1
Kruje	0.9	2.1	2,1	20,7
Berat	0.8	2	3,7	30,2
Durres	1.1	2.1	1,9	16,3
Devoll	1.0	2.2	1,8	30,1
Delvine	0.3	1.6	4,1	42,1
<b>Mesatarja</b>	<b>1</b>	<b>2.0</b>	<b>3,9</b>	<b>21,6</b>

Burimi: Regjistrimi i pergjithshem i njesive ekonomike bujqesore, INSTAT, 1998, dhe Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

Si ndikon kjo ne shfrytezimin ilegal???????

Sic del edhe nga Pasqyra 7, rrethet ne rajonet verior, qendror-lindor dhe veri-perendimor, qe kane dhe siperfaqe te konsiderueshme pyjesh e kullotash, vec tradites per blegtori, sidomos per bagetite e imta, kane ngarkese me te ulet me keto bageti ne nj.e.b.

Jane te rralla ato njesi ekonomike bujqesore, qe mbajne nje numer me te madh kreresh bagetish (si te trasha ashtu dhe te imta), mbareshtimi i te cilave do kerkonte mbeshtetje me kredi lehtesuese dhe me terma favorizuese nga ana e shtetit. Keshtu p.sh. ne nivel Republike, bazuar mbi te dhenat statistikore, ferma me 10-50 lope ose gjedhe per mish jane 128. Ferma me bageti te imta, qe kane 50-100 krere jane 4380; ato me 100-200 krere jane 1150; ato me mbi 200 krere jane 170; ndersa nj.e.b qe mbareshtojne 5-50 dosa jane 145.

### **ESHTE KJO SIPAS VEZHVIMIT TONE APO SIPAS KUJT REFERENCE**

Rrethet perfaqesuese te zones veriore dhe asaj qendrore-lindore kane rendimentet me te ulta ne prodhimin e qumeshtit, tregues ky qe reflekton dhe ne prodhimin e mishit nga kafshet, pasi kane te bejne me mangesite ne shkallen e permiresimit racor dhe, sidomos, me deficitet ne te ushqyerit e blegtorise. Rritja e prodhimit do te beje te mundur edhe shtimin e prodhimeve per treg, pasi aktualisht shumica e familjeve ne nj.e.b. prodhimet e tyre i perdorin per vetkonsum, sic pasqyrohet me poshte:

Pasqyra 18. Njesite ekonomike bujqesore dhe mundesite e tregtimit te prodhimeve te tyre (ne %)

Rrethet	% e nj.e.b. qe shesin produktet e tyre ne treg		
	Bujqesia	Blegtoria	Te perpunuara
Has	11	24,5	7,8
Bulqize	17,8	17	16,2
Kruje	36,8	36,6	16,8
Berat	41,1	40,5	18,4
Durres	45	45,1	9,9
Devoll	44,5	29,2	26,3
Delvine	35,6	27,2	15,8
Republika	33,6	35,7	14,3

Burimi: INSTAT- *Regjistrimi i Pergjithshem i Njesive Ekonomike Bujqesore – 1998*

Nga pasqyra vihet re se rajoni verior dhe ai qendror-lindor shesin shume pak produktet e tyre, gje qe rezulton ne nivel te ulet te te ardhurave. Me tej ky rajon mbase ka dhe perqindjen me te larte te nj.e.b. ne nivelin e mbijeteses (prodhojne per vetkonsum dhe nuk arrijne te shesin asgje). Ka dhe rajone si ai i perfaqesuar nga Devolli, Durresi qe te tera nj.e.b. jane te orientuara drejt tregut dhe e aksesojne ate me nje lloj produkti. Nderkohe, edhe ne jug (Delvine) jane verejtur nj.e.b. qe jane ne nivelin e subsistences.

Pavaresisht nga madhesia e nj.e.b. shumica e tyre plotesojne nevojat per vete-konsum dhe arrijne te dalin ne treg nepermjet produkteve te tilla si (bime arash), drufrutoreve (peme frutore, ullinj, agrume, vreshta), perime etj. Ne vrojtimin tone pesha specifike qe zene keto sisteme ne nj.e.b. ndryshon nga rajoni ne rajon. Duke pare me vemendje zonat ne studim rezulton se, ne rajonin verior sektori i agronomise ze pjesen me te madhe, ne krahasim me rajonet e tjera<sup>4</sup>, nderkohe qe sektori blegtoral ka peshe me te madhe ne rajonin jugor; ndersa perimet kane peshe me te madhe ne rajonin jug-lindor.

**KOMENT PER IVISIN: KETU MBASE DO TE MUND TE PERDOREN DHE KLASFIKIM QE BERA ME IVIN PER SISTEMET E PRODHIMIT NE RAJONE TE NDRYSHME, fuqite be tyre para gjeneruese, dhe krahasimin me te dhenat e instatit mbi nivelin minimi kritik dhe GDPse.**

### 2.3.6 Infrastruktura dhe Sherbimet Publike

#### 2.3.6.1 Sherbimi Shendetsor

Ne pergjithesi niveli i sherbimeve shendetsore ne zonat rurale paraqitet i dobet. Nuk mungojne dhe rastet ekstreme ku fshati nuk ka fare qender shendetsore dhe banoret jane te detyruar te marrin sherbimin ne fshatin me te afert qe ka. Me 1999 shpenzimet

<sup>4</sup> Arsyerja qe rajoni verior ka peshen me te madhe te sektori i agronomise, ne krahasim me rajonet e tjera mund te lidhet me faktin qe ne kete zone i kushtohet vemendje me e madhe ketij sektori ose, me faktin qe, eshte rritur shkalla e industrializimit ne rajonet e tjere. Ajo pjese e tokes qe punohet ne kete rajon mbillet me teper me bime arash (grure, miser), dhe jo se toka e punueshme ne kete rajon ka kushtet me te favorshme per mbjelljen e kulturave te lartpermendura.

buxhetore per shendetin ne Shqiperi ishin rreth 2.1% te PBB-se, nje nga me te ultat ne rajon.

Aktualisht rreth 30% e qendrave ekzistuese shendetsore (ne shkalle vendi jane gjithsej 637 qendra shendetsore dhe 1568 ambulanca), nuk funksionojne per shume arsye, si: mangesi e personelit mjeksore (mjeke vecanerisht) ne zonat e thella rurale, amortizimi i infrastruktures fizike, etj. Per vitin 1999 numri i mjekeve dhe infermiereve per 1000 banore ka qene ne shkalle vendi perkatesisht 1,4 dhe 4,1; ndersa per zonat e thella rurale 0,5- 0,7 mjeke 3,8- 3,9 infermiere. Keta tregues jane me te ulet krahasuar me vendet e Europes Qendrore dhe Juglindore.


Nga vrojtimi del qe, ne disa fshatra me popullsi te besimit katolik (Bize-Durres, Budull-Kruje, etj.), shoqatat fetare perkatese kane ngritur ambulanca/qendra shendetsore, ku jo vetem ilaçet por dhe sherbimi jepet falas, deri tek ai stomatologjik. Organet e pushtetit lokal, te paafte per te bere diçka, nuk i kane penguar keto shoqata ne veprimtarine e tyre humane.

### 2.3.6.2 Arsimimi

Pas vitit 1990 ne fshatin shqiptar vihet re nje renie e interesimit per shkolle, ne veçanti niveli i regjistrimit ne shkollat e mesme, sidomos ne zonat rurale ku ka pesuar nje ulje te ndjeshme. Ne kete nivel arsimi per vitin 1999-2000 u perfshine 43% e te rinjve te grup moshes perkatese (ky tregues ne vitin '90 ka qene 80%, nderkohe qe shtetet fqinje e kane 92- 95%).

Kjo renie shpjegohet jo vetem me uljen e shpenzimeve buxhetore per arsim nga 3.7 e PBB-se me 1995 ne 3,1% te PBB -se ne vitin 1999 (disa shtete keto shpenzime qe ne vitin 1996 i kane patur: Maqedonia 5,1%; Hungaria 4,6%; Sllovenia 5,7%; Italia 4,9%, etj.), por dhe me shkallen e pamjaftueshme te pergjegjesise profesionale te stafit arsimor, zhvleftesimin e formave tradicionale te arsimit profesional, rritjen e kosos per te ndjekur shkollen, etj.

Grafiku 2. Niveli i Arsimit



Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

Zonat rurale paraqiten si me te prekurat nga keto fenomene pa harruar dukurine tanime mjaft te perhapur ne vend, ate te migrimit te brendshem te intelektualeve (migrimi i brendshem i trurit, 24% e njerezve me arsim te larte kane emigruar, SEER, 1999), sidomos nga zonat e thella malore. Mbeshtetur ne pasqyren e mesiperme vetem 2.9% e te intervistuarve kane arsim te larte, nderkohe qe pjesa dermuese paraqiten me arsim tetevjeçar.

Nje tjetër aspekt ka te beje me shperndarjen e pabarabarte te institucioneve arsimore ne territorin e vendin, ku vetem ne pjesen e ultesires perendimore llogariten te jene 7 shkolla te larta, nderkohe qe ne pjesen qendrore-lindore dhe ne ate veriore nuk ka akoma ndonje shkolle te larte.

### 2.3.6.3 Ndhima Sociale

Mjaft studime te meparshme kane konkluduar se programi i ndihmes sociale nuk eshte i perqendruar ne menyre te pershtatshme dhe se ky program jep te nje ndihme modeste ne lehtesimin e varferise te shtresat me te prekura te shoqerise.

Pasqyra 19. % e familjeve qe perfitojne asistencë sociale sipas nivelit te te ardhurave

Te ardhurat mujore (leke)	% e familjeve qe perfitojne asistencë sociale
Deri ne 2,000	33.3
2,001-6,000	15.6
6,001-8,300	14.3
8,301-10,000	14.3
10,001-13,000	3.7
13,001-15,000	14.3
15,001-18,000	12.5
Mbi 18,001	0
Te pa deklaruar	28.6
<b>Gjithsej</b>	<b>14.1</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

**NEVOJA PER KETE TABELLE KA NJE PIKEPYTJE TE MADHE SEPSE 1) nuk eshte kerkuar, 2) ndihme sociale marrin ato familje qe vertetojne se nga pikpamja financiare jane fare te "pjerrdhura"???????**

Sipas statistikave zyrtare te vitit 1999, 149 mije familje (67 mije familje ne qytet dhe 81,3 ne fshat) trajtoheshin me ndihme ekonomike te plote ose te pjeseshme, nderkohe qe studimi nxjerr qe rreth 14% e familjeve rurale perfitojne mbrojtje sociale. Megjithese mungesa e efektivitetit te sistemit te mbrojtjes sociale nuk eshte shume e dukshme, bazuar ne te dhenat e vrojtimit ne fjale, ku perqindja e atyre qe perfitojne kete mbrojtje bie me rritjen e nivelit te te ardhurave te tyre, perqindja e perfituesve eshte relativisht e ulet, pasi varferia ne Shqiperi eshte kryesisht nje fenomen rural, sic eshte shpjeguar dhe me pare.

Kontigjenti i perfituesve duhet te kuptojte se qellimi kryesor i ndihmes ekonomike dhe perkrahjes sociale eshte riaktivizimi i aftesive fizike, per t'iu pershtatur tregut te punes, dhe ne te njejten kohe, te ringjalle nervin perkohesisht te paralizuar te punes, dhe jo te adoptohet me gjendjen ekzistuese te varferise dhe mungesen e perpjekjeve personale

per te dale nga gropa e zese e varferise. Me nje fjale, sado social te jete shteti nuk mund te perballoje varferine per nje kohe te gjate, me asistence sociale.

#### 2.3.6.4 Punesimi dhe Oportunitetet

Sipas statistikave zyrtare (INSTAT, 2001), shkalla aktuale e papunesise vleresohet te jete rreth 17%. Nga 1.283 milione vete te konsideruar si forca aktive pune, 1.068 milione jane te punesuar dhe nga keto 761 mije konsiderohen te vetepunesuar ne bujqesi. Nga ana tjere, FAO ka percaktuar dhe modalitet te caktuara per vleresimin e shkalles se vetepunesimit ne bujqesi (ku merret parasysh struktura e mbjelljes se tokes, mosha e punonjesit dhe madhesia e fermes, shkalla e mekanikes etj). Duke marre parasysh keto tregues dhe bazuar mbi vlerat e tyre sipas dokumentave statistikore te INSTAT, rezulton qe niveli i vetepunesimit ne bujqesine shqiptare te jete rreth 545,000 punonjes bujqesor, pra goxha me pak nga ajol qe raporton INSTAT.

Me nje fjale, duke konsideruar te punesuar (vete-punesuar) dhe ate qe angazhohet ne punet e nje.e.b te tij, papunesia urbane paraqitet me e larte se ajo rurale, kjo gjithnje sipas INSTAT. Kjo si rrjedhoje e shume shkaqeve:

***pike se pari***, migrimi i brendshem apo i quajtur ndryshe eksodi rural, ka sjellur efekte negative ne aspektin social dhe ekonomik, jo vetem per zonat urbane (zonat pritesore), por dhe ne ato rurale (zonat percjellese).

Kontigjenti i migranteve perreth apo ne zonat urbane duke u perballur me veshtiresite e tregut te punes, ka çuar ne lindjen dhe ushqyerjen e nje tregu te ri (ate informal);

***nga ana tjeter***, si rrjedhoje e depopullimit te shpejte te zonave rurale, jeta sociale dhe ekonomike ka ardhur duke u degraduar per mungese sherbimesh apo investimesh te nevojshme urbane.

Pasqyra 20. Familjet me anetare emigrante dhe te angazhuar ne pune te dyta

Te ardhurat mujore (leke)	Te angazhuar ne pune te dyte (%)	Te punesuar jashte shtetit (%)
Deri ne 2,000	6.6	26.7
2,001-8,3000	24.5	65.2
8,301-10,000	42.9	42.9
10,001-13,000	22.2	51.9
13,001-15,000	42.9	52.4
15,001-18,000	50.0	12.5
18,001-24,000	35.7	57.1
24,001-31,000	20.0	20.0
Mbi 31,000	50.0	83.3
Te pa deklaruar	19.0	62.0
<b>Gjithsej</b>	<b>24.4</b>	<b>42.9<sup>5</sup></b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

## IVIS: INTERVALET DUHET TE AXHUSTOHEN

<sup>5</sup> Dihet qe nje pjese e tyre jane te punesuar ne pune sezonale dhe pa dokumenta.

Nje tjetër aspekt është dhe emigracioni i jashtëm. Sipas gjetjeve të vrojtimit, rreth 43% e familjeve të intervistuar kanë të paktën nga një pjesëtar të punësuar jashtë shteti, që në disa raste nuk mund të përgjithësohet si tregues i përmirësimit të situatës financiare të familjeve fshatare.

### 2.3.7 Përdorimi i Druve të Zjarrit

Bazuar në të dhënat e studimit rezulton që, 33.2% e familjeve rurale përdorin drutë të zjarrit disa here në ditë, ndërsa 31.7% e tyre i përdorin vazhdimisht. Prandaj arrijmë në konkluzionin se, lenda djegëse e drurit, mbetet akoma një nga burimet përsosore në plotësimin e nevojave familjare (si p.sh. ngrohja) në zonat rurale. (Shih Graf. 6).

Pasqyra 21. Shpeshësia e përdorimit të drutëve të zjarrit sipas nivelit të të ardhurave


Niveli i të ardhurave mujore (leke)	Shpeshësia e përdorimit të drutëve të zjarrit						Gjithsej
	Gjithnjë	Disa here në ditë	1 here në ditë	Rralle	E kam por nuk e përdor	Nuk e zoteroj këtë burim	
Deri në 2,000	11	4	0	0	0	0	15
2,001-6,000	9	13	6	3	1	0	32
6,001-8,300	13	11	8	1	2	0	35
8,301-10,000	7	11	2	0	1	0	21
10,001-13,000	8	10	2	2	2	3	27
13,001-18,000	13	6	5	3	2	0	29
18,001-31,000	2	5	6	1	4	1	19
Mbi 31,000	0	0	1	1	2	2	6
Te pa deklaruar	2	8	9	2	0	0	21
<b>Gjithsej fam. (nr)</b>	<b>65</b>	<b>68</b>	<b>39</b>	<b>13</b>	<b>14</b>	<b>6</b>	<b>205</b>
<b>Gjithsej fam. (%)</b>	<b>31.7</b>	<b>33.2</b>	<b>19</b>	<b>6.3</b>	<b>6.8</b>	<b>3</b>	<b>100.0</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

### IVIS: INTERVALET DUHET TË AXHUSTOHEN

Jane përkrahur familjet e dobëta ekonomike të cilat përdorin pothuajse vazhdimisht këtë lloj burimi. Familjet me një nivel të ardhurash deri në 15,000 leke përbejnë rreth 89% të atyre që përdorin vazhdimisht drutë të zjarrit (Shih Pasqyrën 12).

Grafiku 4. Shpeshtesia e perdorimit te druve te zjarrit



Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

Duke iu referuar Pasqyres 12 vihet re nje raport i zhdrejte midis te ardhurave ne familje dhe shpeshtesise te perdorimit te druve te zjarrit, domethene se ka nje prirje ne rnie te shpeshtesise ne perdorimin e druve te zjarrit me rritjen e nivelit te te ardhurave Pra, ne kete kendveshtrim, fenomeni varferi do te thote fenomen i perdorimit te druve te zjarrit per nevoja familjare (ngrohje, gatim, etj.) me probabilitet te larte per sigurimin e tyre, nepermjet prerjeve ilegale te pyjeve<sup>6</sup>.

Dihet fakti qe perqindja e perdorimit te druve te zjarrit gjate stines se dimrit eshte me e larte se ajo gjate stines se veres, meqenese nevojave per gatim u shtohen dhe ato per ngrohje, por jo gjithnje ne raport 2:1. Ka disa familje ne zonat rurale qe, zakoni "zjarri ze zjarrin" vlen dhe gjate stines se veres per arsye te ndonje pjesetari te moshuar ne familje, pranise se femijeve te vegjel apo dhe thjeshte te tradites familjare. Po t'i referohemi Pasqyres 13, shohim se 68% e nevojave te familjeve rurale per burime ngrohje te tilla si: dru zjarri, vajguri, nafte, energji elektrike, gaz apo tjetër, mbulohen nga drute e zjarrit gjate stines se dimrit, nderkohe qe gjate stines se veres keto te fundit zene 53% te perdorimit te burimeve te tjera te lartpermendura.

Pasqyra 22. Periodiciteti i perdorimit te druve te zjarrit sipas nivelit te te ardhurave

#### <sup>6</sup> A ESHTE E VETETE KJO KETU

Duhet sqaruar fillimisht se cilat konsiderohen prerje te paligjshme (ilegale) pasi jo te gjithë drute e zjarrit te marra direkt nga pylli (pa pagese) klasifikohen si te paligjshme. Ka pjese pyjore ne ekonomi te ndryshme te caktuara nga komunat perkatese, per shfrytezimin e druve te zjarrit nga ana e fshataresise. Ne kete rast lenda djegese merret direkt nga pylli dhe fshatari nuk paguan per kete. Me te drejte lind pyetja si do te identifikohen prerjet e paligjshme? Mospagimi i druve te zjarrit nuk perben ne vetevete nje fenomen te paligjshem, por çmimi zero i nje burimi natyror çon ne mungesen e tregut te ketij produkti dhe, si rrjedhoje, do çoje ne shperdorimin e tij, pasi kerkesa per te do jete e larte dhe oferta do sigurohet me çmimin e barabarte me zero. Me nje fjale konsumi i druve te zjarrit me çmimin baraz me zero (qofte dhe ne pjesen/parcelen e ligjeruar) eshte nje nga menyrat qe çon ne fenomenin e prerjeve ilegale, por qe ne vetevete nuk perben ate. Prerjet ilegale kane te bejne me teper me demtimet dhe prerjet pa kriter, qe konfliktuojne anen teknike te tyre, si per shembull prerjet barbare anes rrugeve pa permbushur kushtet teknike (prerja jo ne fund e drurit), apo dhe shperdorimet e asortimentit drunor (rastet kur lenda e punimit shfrytezohe per dru zjarri).

Te ardhurat mujore (ne leke)	Periodiciteti i perdorimit te druve te zjarrit (%)	
	Gjate stines se dimrit	Gjate stines se veres
Deri ne 2,000	99.6	98.0
2,001-6,000	72.3	52.8
6,001-8,300	79.4	39.0
8,301-10,000	74.5	61.7
10,001-13,000	60.0	40.0
13,001-15,000	67.6	61.1
15,001-18,000	80.0	70.0
18,001-31,000	78.6	29.9
Mbi 31,000	10.0	0.0
Te pa deklaruar	45.2	40
<b>Mesatartja</b>	<b>68</b>	<b>53</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

#### IVIS: INTERVALET DUHET TE AXHUSTOHEN


Energjia elektrike mbetet akoma burim i konsiderueshem i energjise, e cila mbulon rreth 33% te nevojave familjare gjate stines se veres dhe 21% gjate asaj te dimrit. Tanime dhe ne zonat rurale, vajguri/nafta kane gjetur zevendesues, gazin e lengshem, perdorimi i te cilit eshte me i larte gjate stines se veres sesa asaj te dimrit (perkatesisht 13% dhe 9%). Por, ne familjet e varfera drute e zjarrit mbulojne pothuajse 100% kerkesat e tyre per burime ngrohje, pa ndonje diference te madhe midis stineve.

Ndersa po te flasim vetem per nevojat totale vjetore per ngrohje (Shih Grafiku 5), verejme se drute e zjarrit mbulojne 78% te ketyre nevojave, nderkohe qe rreth 53% e familjeve ne fshat perdorin drurin per te gatuar (shih Grafiku 6).


Fakti i theksuar me lart se, familjet e varfera perdorin me teper drute e zjarrit (meqenese sigurohen lehte, lire dhe pa kufizim sasie) konfirmohet dhe nga te dhenat e Pasqyres 14, ku familjet me te ardhura mujore deri ne 2,000 leke perdorin 100% dru zjarri per ngrohje dhe pothuajse vetem keto te fundit per gatim (94%). Per me teper, shohim se me rritjen e te ardhurave perqindja e druve te zjarrit si per ngrohje ashtu dhe per gatim bie duke u zevendesuar me burimet e tjera energjitike.

Grafiku 3. Intensiteti dhe perdorimet e burimeve te energjise





Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001



Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

15.59  
6

100.7 + ... + 76,36 · 21


---

208

Pasqyra 23. Përqindja e nevojave totale vjetore për ngrohje sipas nivelit të të ardhurave

Te ardhurat mujore (leke)	Përqindja e nevojave totale vjetore për ngrohje				
	Dru zjarri	Vajguri, naftë	Energji elektrike	Gaz	Gjineshter
Deri në 2,000	100	0	0	0	0
2,001-6,000	81.1	0.9	14.9	3.1	0
6,001-8,300	86.6	0	8	5.4	0
8,301-10,000	85.2	2.4	9.1	3.3	0
10,001-13,000	71.1	0	18.1	10.8	0
13,001-15,000	76.0	0	17.3	6.7	0
15,001-18,000	83.8	0	16.2	0	0
18,001-24,000	68.2	0	11.4	20.4	0
24,001-31,000	58.0	0	26	16	0
Mbi 31,000 leke	17.5	16.7	33.3	31.7	0.8
Te pa deklaruar	75.7	0	23.1	1.2	
Mesatarja	73.0	1.8	16.2	8.9	0.1

## IVIS: INTERVALET DUHET TË AXHUSTOHEN



Pasqyra 24. Burimet energjitike e perdorura per gatim

Te ardhurat mujore (leke)	Burimet e perdorura					Gjiths ej
	Dru zjarri	Vajguri & naftë	Energji elektrike	Gaz	Gjineshter	
Deri ne 2,000	15	0	0	1	0	16
2,001-6,000	28	0	18	3	0	49
6,001-8,300	33	0	13	3	0	49
8,301-10,000	18	0	10	4	0	32
10,001-13,000	17	0	11	10	1	39
13,001-15,000	16	0	9	6	0	31
15,001-18,000	7	1	3	2	0	13
18,001-24,000	8	0	8	7	0	23
24,001-31,000	2	0	4	2	0	8
Mbi 31,000	2	1	1	5	1	10
Te pa deklaruar	17	1	19	0	0	37
<b>Totali i Intervistave</b>	<b>163</b>	<b>3</b>	<b>96</b>	<b>43</b>	<b>2</b>	<b>307 ???</b>
<b>Grupi ndaj Totalit (%)</b>	<b>53.1</b>	<b>1.0</b>	<b>31.3</b>	<b>14.0</b>	<b>0.7</b>	<b>100</b>


Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

**IVIS: INTERVALET DUHET TE AXHUSTOHEN, KETU KA ME SHUME SE 205 intervista qe duhet te ishin**

### 2.3.8 Konsumi Mesatar Vjetor i Druve te Zjarrit (mst<sup>2</sup>)

Nga studimi del qe rreth 27% e familjeve rurale konsumojne mesatarisht gjate nje viti 6-9mst dhe rreth 20% e tyre konsumojne 12-15mst. Nje perqindje pothuajse e paperfillshem (1%) e familjeve konsumojne mbi 15mst (Shih Grafikun 8). Kjo per faktin qe edhe ne zonat rurale ka filluar konsumimi i gazit te lenget.

Grafiku 8. Konsumi mesatar vjetor i druve te zjarrit



Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

??????????

<sup>7</sup> 1 meter stere =0,6 m<sup>3</sup>

Rreth gjysma e familjeve të grupuara në nivelin e konsumit mbi 15mst, nuk i perdorin fare drute e zjarrit, nga të cilat pjesa më e madhe e tyre i perkasin familjeve me një nivel të kenaqshëm të ardhurash që, janë në gjendje të blejnë zevendesuesit e druve të zjarrit.

**????????? ATHER PERSE JANE FUTUR NE ATE INTERVAL???????**

Po keshit, raportin e garte të zhdrejte midis nivelit të te ardhurave dhe konsumit të lëndes drusore mund ta verëjmë dhe nga të dhenat e pasqyres së mëposhtme.

Pasqyra 25. Konsumi mesatar vjetor i druve të zjarrit sipas nivelit të te ardhurave

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QSHKE, 2001

Te ardhurat mujore (leke)	Konsumi mesatar vjetor i druve të zjarrit (mst)						Gjithsej
	Zero konsum	Deri në 3	3-6	6-9	9-12	12-15	
Deri në 2,000	0	0	1	0	8	6	15
2,001-6,000	1	6	1	0	15	9	32
6,001-8,300	2	3	4	7	10	8	35
8,301-10,000	1	2	1	12	1	4	21
10,001-13,000	5	4	7	6	5	0	27
13,001-15,000	3	5	0	10	0	3	21
15,001-18,000	0	2	0	4	0	0	8
18,001-31,000	5	6	1	5	2	0	19
Mbi 31,000	5	1	0	0	0	0	6
Te padeklaruara	1	4	1	11	1	2	21
Gjithsej fam.(m)	23	33	16	55	35	41	205
Gjithsej fam.(%)	11.2	16.1	7.8	26.8	17.1	20.0	100.0

Per konsumin mesatar vjetor të druve të zjarrit, sipas zonave të marra në studim, gendron llogjika që në zonat relativisht të ftohta (veriore, qendrore-lindore, veriperendimore dhe juglindore), konsumi i druve të zjarrit është më i lartë.

Pasqyra 26. Konsumi mesatar vjetor i druve të zjarrit sipas rretheve

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QSHKE, 2001

Rrethi	Konsumi mesatar vjetor i druve të zjarrit (mst)						Gjithsej
	Zero konsum	Deri në 3	3-6	6-9	9-12	12-15	
Has	0	5	1	8	5	11	0
Bulgize	2	12	0	9	6	1	0
Kruje	4	3	0	8	1	13	1
Berat	2	4	3	7	10	3	1
Dures	4	6	4	8	0	8	0
Devoll	0	0	0	13	8	4	0
Delvine	11	3	8	2	5	1	0
Totali Intervistave	23	33	16	55	35	41	2
Grupi ndaj Totalit (%)	11.2	16.1	7.8	26.8	17.1	20.0	0.9

**IVIS: INTERVALI DUEHT TE AXHUSTOHEN**

Me anën e disa llogaritjeve të thjeshta mund të japin një vlerësim lidhur me konsumin mesatar vjetor të një familje rurale per secilin rreth perfaqesues të rajoneve.

*Ku janë përvojat?*

$$K_{MV}^{has} = [(0mst \cdot 0) + (1.5mst \cdot 5) + (4.5mst \cdot 1) + (7.5mst \cdot 8) + (10.5mst \cdot 5) + (13.5mst \cdot 11) + (16.5mst \cdot 0)] \cdot 30$$

$$K_{MV}^{has} = (7.5 + 4.5 + 60 + 52.5 + 148.5) mst = 30$$

Siç del dhe nga perlllogaritjet e mesiperme konsumi mesatar vjetor i druve te zjarrit per nje familje ne fshat eshte me i ulet ne rajoni jugor dhe ne ate te ultesires perendimore, perkatesisht 4.0 dhe 6.5mst. Kjo piksepari shpjegohet me klimen e ngrohete te te dy rretheve perfaqesuese. P.sh. Durresi si rreth i zones mesdhetare fushore ka nje temperature mesatare te ajrit prej 16.4°C<sup>9</sup> ku vetem gjate stines se dimrit 40 dite jane te kthjellta, nderkohe qe rrethet e tjera perfaqesuese, shumica e te cilave i takojne zones mesdhetare paramalore (Has, dhe Devoll) kane nje temperature mesatare te ajrit prej 11.9°C.

Bazuar ne informacionin e perftuar nga vrojtimi mbi shpeshtesine e perdorimit te druve te zjarrit dhe sasine e harxhuar mesatarisht gjate nje viti, mund te perlllogarisim sasine e lendes se drurit qe konsumon nje familje rurale shqiptare mesatarisht gjate nje viti (KMV).

**Perlllogaritja 1. KMV e ponderuar nga shpeshtesia "vazhdimisht"**

$$\begin{aligned} KMV^1 &= [(4.5 \cdot 1) + (7.5 \cdot 21) + (10.5 \cdot 21) + (13.5 \cdot 19) + (16.5 \cdot 2)] \div 65 \\ KMV^1 &= (4.5 + 157.5 + 220.5 + 256.5 + 33) \div 65 \\ KMV^1 &= 672 \div 65 \\ KMV^1 &= 10.3mst \end{aligned}$$

**Perlllogaritja 2. KMV e ponderuar nga shpeshtesia "disa here ne dite"**

$$\begin{aligned} KMV^2 &= [(4 \cdot 15) + (7.5 \cdot 21) + (10.5 \cdot 10) + (12 \cdot 22)] \div 68 \\ KMV^2 &= (60 + 157.5 + 105 + 264) \div 68 \\ KMV^2 &= 586.5 \div 68 \\ KMV^2 &= 8.6mst \end{aligned}$$

**Perlllogaritja 3. KMV e ponderuar nga shpeshtesia "1 here ne dite"**

$$\begin{aligned} KMV^3 &= [(3 \cdot 22) + (7.5 \cdot 13) + (10.5 \cdot 4)] \div 39 \\ KMV^3 &= (66 + 97.5 + 42) \div 39 \\ KMV^3 &= 205.5 \div 39 \\ KMV^3 &= 5.3mst \end{aligned}$$

**Perlllogaritja 4. KMV e ponderuar nga shpeshtesia "Rralle"**

$$\begin{aligned} KMV^4 &= (2 \cdot 11) \div 13 \\ KMV^4 &= 22 \div 13 \\ KMV^4 &= 1.7mst \end{aligned}$$

KMV eshte e barabarte me mesataren e ponderuar te  $KMV^1$ ,  $KMV^2$ ,  $KMV^3$  dhe  $KMV^4$ :

**Perlllogaritja 5. Konsumi Mesatar Vjetor**

$$\begin{aligned} KMV &= (65 \cdot 10.3) + (68 \cdot 8.6) + (39 \cdot 5.3) + (13 \cdot 1.7) \div 205 \\ KMV &= (669.5 + 584.8 + 206.7 + 22.1) \div 205 \\ KMV &= 1483 \div 205 \end{aligned}$$

---


$$KMV_{Has} = 273mst \div 30$$

$$KMV_{Has} = 9.1mst$$

<sup>9</sup> Sipas te dhenave te stacioneve meterologjike per vitin 1990.


$$KMV=7.2mst$$

$$KMV=4.3m^3$$

Kjo do te thote qe nje familje fshatare shqiptare harxhon mesatarisht gjate nje viti rreth  $4m^3$  dru zjarri<sup>10</sup>.

Prandaj po te vazhdohet me kete llogjike, nuk do te ishim shume larg realitetit po te perlllogaritnim sasine e druve te zjarrit te shpenzuar ne vend gjate vitit 2000, duke ditur qe rreth 396,8 mije familje jetojne ne fshat<sup>11</sup>.

KTDZ 2000 (konsumi total i druve te zjarrit) =  $396,8 * 4 \approx 1.6$  milione  $m^3$ .




i: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

Look  
u

<sup>10</sup> Vleresimi lidhur me KMV-ne eshte ndoshta pak i larte, por te mos harrojme qe periudha ne te cilen eshte kryer vrojtimi (Mars-Prill 2001) nuk eshte shume larg, per te mos thene qe perkon me krizen e thelle energjitike te cilen kaloi vendi.

<sup>11</sup> INSTAT: Regjistrimi i Pergjithshem i Popullsise, Prill 2001.

Grafiku 10. Konsumi mesatar vjetor i druve te zjarrit sipas nivelit te te ardhurave (mst)




Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

### 2.3.9 Sigurimi i Druve te Zjarrit

Te dhenat tregojne qe 60% e familjeve i sigurojne drute e zjarrit drejperdrejt nga pylli. Keto jane familje me nivel te ulet te ardhurash. Kjo nuk do te thote se kemi te bejme me prerje te paligjshme, pasi, sic kemi theksuar me siper, vete komunitat i caktojne popullsiset fshatare parcela pjore ku kjo te lejohet te marri dru zjarri.


Grafiku 12: Burimi i sigurimit te druve te zjarrit



Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

Fakti që kjo përqindje (60) e popullsisë fshatare nuk paguajnë për sasinë e druve të zjarrit, duke e siguruar drejtpërdrejt nga pylli, nuk do të thote gjë për prerjet e paligjshme (*Lexo shenimin në fq 19*). Sigurimi i druve të zjarrit direkt nga pylli duhet të trajtohet në një kompleks me të gjere, duke vlerësuar numrin e njesive bujqesore të përfshira në prerjet abuzive të pyjeve. Fakti i sigurimit të druve të zjarrit direkt nga pylli, së bashku me arsyen e sigurimit të tyre lehtë, lire dhe pa kufizim sasi, si dhe mospagimi i vlerës monetare të tyre, do të përbenin ndoshta treguesin më të përafert të problemit në fjalë. I njëjti arsyetim do të bëjë dhe për rastin kur burimi i sigurimit të lëndës djegëse të drurit është pylli i një komune tjetër. Me sa u tha më sipër, jemi në gjendje të paraqesim fazat drejt vlerësimit të prerjeve ilegale të pyjeve me anën e skemës së mëposhtme:

Skema 1. Fazat e vlerësimit të sigurimit ilegal të druve të zjarrit



Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

Bazuar në analizen e të dhënave të grumbulluara nga vrojtimi sidhe në detajimet e skemës së mesiperme, vlerësohet që 12.2% e popullsisë fshatare të vendit sigurojnë drutë e zjarrit ilegalisht. Duke ditur që konsumi total i druve të zjarrit gjatë vitit 2000 vlerësohet të jetë 1.6 milionë m<sup>3</sup>, arrijmë në përfundimin se 195,2 mijë m<sup>3</sup> prej tyre janë prera në formë të paligjshme.

Sigurimi i druve të zjarrit të blera nga një tregtar i paidentifikuar është një informacion që jepet për prerjet ilegale. Por, për të shmangur përlogaritjet e dyfishta është lënë që, sasia e vlerësuar në këto rast, të nxirret nga procesi i monitorimit të postbllloqeve, ku kamionet pa leje transporti do ndalohen dhe regjistruhen.

Familjet me një nivel të ardhurash deri në 15,000 leke përbejnë rreth 80% të atyre që sigurojnë drutë e zjarrit në formë të paligjshme. Keto i perkasin, kryesisht, rrethëve Has, Devoll dhe Bulqize.

Familjet rurale, të cilat i sigurojnë drutë e zjarrit me para (rreth 81%), i blejnë nga tregtarë të paidentifikuar. Mendojmë se kjo shifer duhet të merret me rezervë, sepse, shpesh, nën termin "tregtar i paidentifikuar" mund të fshihet një pjesë e popullsisë rurale, e cila siguron drutë e zjarrit drejtpërdrejt nga pylli, por që nuk dëshiron të deklarohet si e tillë. Kuptohet, në kushtet e të ardhurave të pakta të familjeve rurale,

<sup>12</sup> Shifra vlerësohet të jetë më e lartë pasi ka patur një korrelacion midis kesaj alternative dhe opsionit "s'ka burim tjetër për ngrohje".

probabiliteti i blerjes se druve te zjarrit mendojme se ekziston vetem atehere kur nuk ka mundesi qe ato te sigurohen "falas", duke i prere ne pyll. Praktika e marrjes se druve te zjarrit nga pylli i nje komune tjeter eshte pothuajse e paperfillshme, per vete traditat dhe zakonet e fshatrave shqiptare.

Pasqyra 27. Burimi i sigurimit te druve te zjarrit sipas rretheve

Rrethi	Burimi i sigurimit					
	Direkt ne pyllin tone <sup>13</sup>	Direkt nga pylli i nje komune tjeter	Blere nje tregtari te pa identifikuar	Blere nga nje perdorues i kontraktuar nga komuna	Tjeter (krasitje ulliri, shkurre te thara ne pyll)	Pa pergjigje
Has	20	0	8	2	0	0
Bulqize	14	1	5	8	0	2
Kruje	16	0	12	1	0	1
Berat	28	0	0	0	0	2
Durres	18	0	4	0	4	4
Devoll	17	0	8	0	0	0
Delvine	10	0	9	0	0	11
<b>Totali intervistave</b>	<b>123</b>	<b>1</b>	<b>46</b>	<b>11</b>	<b>4</b>	<b>20</b>
<b>Grupi ndaj Totalit %</b>	<b>60.0</b>	<b>0.5</b>	<b>22.4</b>	<b>5.4</b>	<b>2.0</b>	<b>9.8</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

CFARE DO TE THOTE "Blere nga nje perdorues i kontraktuar nga komuna" NUK EGZISTON NJE I TILLE.

Pasqyra 28. Burimi i sigurimit te druve te zjarrit sipas nivelit te te ardhurave

Te ardhurat mujore (ne leke)	Burimi i sigurimit					
	Direkt ne pyllin tone	Direkt nga pylli i nje komune tjeter	Blere nje tregtari te pa identifikuar	Blere nga nje perdorues i kontraktuar nga komuna	Gjineshter /krasitje ulliri	Pa pergjigje
Deri ne 2,000	12	0	2	0	1	0
2,001-6,000	22	0	6	3	0	1
6,001-8,300	23	0	8	1	1	2
8,301-10,000	10	0	8	2	0	1
10,001-13,000	15	0	7	1	0	4
13,001-15,000	16	0	1	2	0	2
15,001-18,000	6	0	1	0	1	0
18,001-24,000	6	0	5	0	0	3
24,001-31,000	2	0	0	0	1	2
Mbi 31,000	0	0	2	0	0	4
Te padeklaruar	11	1	6	2	0	1
<b>Totali intervistave</b>	<b>123</b>	<b>1</b>	<b>46</b>	<b>11</b>	<b>4</b>	<b>20</b>
<b>Grupi ndaj Totalit %</b>	<b>60.0</b>	<b>0.5</b>	<b>22.4</b>	<b>5.4</b>	<b>2.0</b>	<b>9.8</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

## IVIS: INTERVALET DUHET TE AXHUSTOHEN

<sup>13</sup> Nenkuptojme marrjen e druve ne pyllin e fshatit dhe jo pyjet komunale, pasi jo ne te gjitha komunat jane kaluar pyjet ne perdorim te tyre.

### 2.3.10 Alternativat e Perdorimit te Drute e Zjarri

Bazuar ne te dhenat e vrojtimit del qe, rreth 47% e te intervistuarve rradhisin mospasjen e nje burimi tjeter alternativ per ngrohje si, nje nga arsyet paresore te perdorimit te druve te zjarrit. Kesaj pergjigjeje i shtohet edhe fakti qe, ato sigurohen lehte, lire dhe pa kufizim sasie. Po t'i referohemi pasqyres se meposhtme do te shohim qe familjet me nje nivel te te ardhurave deri ne 15,000 leke perbejne 82% e atyre qe rradhisin mosekzistencen e nje burimi tjeter ngrohje, si arsye kryesore. Sidoqofte, mendojme qe, ne dhenien e pergjigjes kesaj pyetjeje ka patur nje vetelidhje midis 2 alternativave te para (s'ka burim tjeter per ngrohje dhe sigurohet lehte, lire dhe pa kufizim sasie). Vec kesaj ne pergjigje theksohet se ne kushtet e nje varferie te madhe "nuk ka burim tjeter per ngrohje", sepse perdorimi i burimeve alternative kerkon shpenzime monetare mjete te cilat mungojne. Keshtu arrijme ne konceptimin e alternativës se pare si nje mospasje te nje burimi, i cili sigurohet lehte, lire dhe pa kufizim sasie.

Pasqyra 29. Arsyet e perdorimit (me teper) te druve te zjarrit sipas nivelit te te ardhurave

Te ardhurat mujore (ne leke)	Arsyeja e perdorimit te druve te zjarrit				
	S'ka burim tjeter per ngrohje	Sigurohet lehte, lire dhe pa kufizim sasie	Eshte tradite familjare	Tjeter (si arsyet shendetsore)	Pa pergjigje
Deri ne 2,000	12	2	0	1	0
2,001-6,000	15	11	4	1	1
6,001-8,300	20	10	2	0	3
8,301-10,000	7	8	4	0	2
10,001-13,000	16	6	0	0	5
13,001-18,000	13	10	3	0	4
18,001-31,000	6	7	1	0	5
Mbi 31,000	0	1	0	0	5
Te pa deklaruar	7	5	7	1	1
<b>Gjithsej fam. (nr)</b>	<b>96</b>	<b>59</b>	<b>21</b>	<b>3</b>	<b>26</b>
<b>Gjithsej fam. (%)</b>	<b>46.8</b>	<b>28.8</b>	<b>10.2</b>	<b>1.5</b>	<b>12.7</b>


Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

## IVIS: INTERVALET DUHET TE AXHUSTOHEN

### 2.3.11 Perfitimi i Druve te Zjarrit Kundrejt Cfare Kostoje

Nga analiza e te dhenave nga ky vrojtim, konfirmojne se rreth 39% e familjeve rurale nuk paguajne per drute e zjarrit. Mirepo, vetem duke ditur qe 60% e tyre i marrin drute e zjarrit drejtperdrejt nga pylli, gje qe nenkupton konsum falas, shifra e mesiperme duket si e dhene ne nivele te nenvleresuar. Kete fakt e verejme dhe ne grafikon e meposhtem:

Grafiku 12. Çmimi i blerjes se nje mst dru zjarri



Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

Besueshmerine e ulet ne pergjigje te kesaj pyetjeje mund ta verejme dhe te perqindja e familjeve rurale, te cilet paguajne mbi 1,000 leke per 1 mst dru zjarri, e cila eshte pak me e larte (vetem 1%) se atyre qe paguajne deri ne 500 leke mst. Dy çmimet e tregut te lartepmendura jane dy vlerat e mundshme ekstreme.

Analiza e pergjigjeve per pyetjen e mesiperme te çon ne faktin se, nga njera ane, eshte pak e veshtire te pranohet hapur ne nje intervistim, se drute e zjarrit sigurohen falas, permes prerjes ne pyll dhe, nga ana tjeter, me karakterin e tyre disi "krenare", familjet rurale perpiqen qe, duke rritur nivelin e shpenzimeve te tyre per dru zjarri, te fshehin nje pjese te varferise se tyre qe, gjithesesi, eshte mjaft e dukshme.

Pasqyra 30. Çmimi i blerjes se nje mst dru zjarri sipas nivelit te te ardhurave

Te ardhurat mujore (leke)	Çmimi i blerjes se nje mst (ne leke)					
	Deri ne 500*	501-750	751-1,000	Mbi 1,000	Nuk paguaj	Pa pergjigje
Deri ne 2,000	6	0	0	2	7	0
2,001-6,000	5	1	4	4	17	1
6,001-8,300	7	0	3	7	15	3
8,301-10,000	4	2	1	7	5	2
10,001-13,000	5	0	1	8	9	4
13,001-15,000	3	1	2	3	10	2
15,001-24,000	5	0	0	6	8	3
24,001-31,000	2	0	0	0	1	2
Mbi 31,000	0	0	0	2	0	4
Te pa deklaruar	1	0	7	0	9	4
<b>Gjithsej fam.(nr)</b>	<b>38</b>	<b>4</b>	<b>18</b>	<b>39</b>	<b>81</b>	<b>25</b>
<b>Gjithsej fam. (%)</b>	<b>18.5</b>	<b>2.0</b>	<b>8.8</b>	<b>19.0</b>	<b>39.5</b>	<b>12.2</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

## IVIS: INTERVALET DUHET TE AXHUSTOHEN

Pasqyra 31. Numri i subjekteve te materialit drusor sipas rretheve

Rrethi	Subjekte te materialit drusor			Gjithsej
	Shfrytezim	Tregtim	Perpunim	
Has	0	25	10	35
Bulqize	15	35	13	63
Kruje	0	5	22	27
Berat	0	0	31	31
Durres	0	0	10	10
Devoll	0	0	25	25
Delvine	0	0	4	4
<b>Gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>65</b>	<b>113</b>	<b>193</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

SSSSTTTTTRRRRRRRRAAAAAAAAAANNNNNNNNNNOOOOOOOOOO

NESE DO TE PARAQITet nje table e tille, qe mesa e Di une nuk eshte kerkuar, do te duhet te themi pastaj se sa jane me license dhe sa pa license, sa shesin/blejne lenden e pare/produktet e perpunuara, ku dhe kujt ia shesin/blejne etj si keto.

### 2.3.12 Ndertimi/Rikonstruktuar i Shtepive/Lokale/Fermave

Nga vrojtimi del qe, vetem 23% e familjeve nj.e.b. kane patur nevoje per lende drusore per ndertimin apo rikonstruktimin e shtepive, lokaleve dhe te stallave. Kjo shifer mund te shpjegohet me faktin se gjate dhjetevjeçarit te fundit Shqiperia eshte perballuar me nje depopullim te pershpjettuar te zonave te ndryshme te vendit, fluksi i te cileve ka qene i drejtuar ne zonat fushore dhe, ne veçanti, ne rajonin Tirane-Durres-Fushe Kruje. Ky rajon sipas parashikimeve te specialisteve, mendohet te strehoje ne nje hark kohor prej 15 vjetesh 2/3 e popullsise te te gjithë vendit nese migrimi do vazhdoje me te njejtin ritem (Center for Habitat Development).

Eshte llogjike qe, ndertimet apo rikonstruktimet te jene ndermarre nga familje me gjendje te mire ekonomike dhe, ne nje fare menyre te dhenat e meposhtme paraqesin kete lidhje pozitive, midis nivelit te te ardhurave dhe ndertimeve/rikonstruktive te bera. Pjesa dermuese e nj.e.b. (36%) qe kane patur nevoje per lende drusore, e kane siguruar ate nga nje tregtar i pidentifikuar dhe 22% e tyre e kane siguruar ate direkt nga pylli.

Fakti qe nje pjese e popullsise fshatare kane siguruar lenden e drurit nga tregtare te pidentifikuar nuk perben nje tregues te sakte, per te vleresuar sasine e lendes drusore te hequr nga pylli ne forme ilegale. Kjo, per dy arsye:

- *se pari*, sasia e lendes drusore te shitur nga subjektet ne fjale mund te perlllogaritet nga monitorimi i postobloqeve, me saktesi disi me te larte se ky vrojtim dhe, per te shmangur perlllogaritjet e dyfishta, eshte me e udhes qe lenda drusore e marre nga pylli ne menyre ilegale te vleresohet nga regjistrimi dhe matja e ngarkeses te kamioneve pa leje transporti;

- *arsyeja e dyte* ka te beje me faktin se, ne disa raste, tregtari i paidentifikuar eshte nenkuptuar si i tille nga bleresi individual dhe jo nga ligji apo menaxhuesit e pasurise pyjore kombetare (pa license te ushtrimit te veprimtarise).

Prandaj vetem lenda e siguruar drejtperdrejt nga pylli do konsiderohet si pjese e terhequr nga pylli ne forme te paligjshme. Megjithate, dhe ne kete rast duhet te jemi te kujdesshem ne menjanimin e vleresimeve te dyfishta, ato te bazuara nga matjet ne ngastra (parcela). **NE VEND TE TEORISE DUHET TE THEMI SE CFARE BEME NE PRAKTIKE DHE CILAT JANE SHIFRAT DH OPINIONET QE DALIN.**

??????

Keshtu bazuar ne analizen e te dhenat te grumbulluara ne kuadrin e ketij vrojtimit del qe rreth 28m<sup>3</sup> lende drusore jane siguruar nga pylli ne menyre ilegale.

**?????? CFARE DO TE THOTE KJO 28 m3 eshte nje fije shkrepsje qe firma kontrabanduese Xh&M e perballojne si produkt te kalbur apo bad debts????**

Duke pergjithesuar çeshtjen ne fjale do te mund te perlogarisim me perafersi prerket ilegale ne shkalla vendi, si meposhte:

- Gjate 5 viteve te fundit kane patur nevojte per lende drusore rreth 24% e familjeve te nj.e.b., ose 95,2 mije familje (396,8 x 24/100);
- Nga keto 95,2 mije familje 22% prej tyre, ose 20,9 mije familje e kane siguruar lenden drusore drejtperdrejt nga pylli, duke marre ne forme ilegale 58,5 mije m3 (20.900x28/11);

????? çfare m3, mst Keshtu, ne shkalle vendi vleresohet te jene terhequr nga pylli rreth 58 mije lende drusore ne menyre te paligjshme. ?????

Pasqyra 32. Ndertimet e bera dhe burimi i sigurimit te lendes

Te ardhurat mujore	Gjithse j	Nga keto kane patur nevojte per lende drusore	Burimet e sigurimit te lendes drusore				Pa pergjigje
			Direkt ne pyll	Blere nga nje subjekt shfrytezimi	Blere nga nje perpunues	Blere nga nje tregtar i paidentifikuar	
Deri ne 2,000	15	2	0	0	2	2	0
2,001-6,000	32	2	0	0	2	3	0
6,001-8,300 +	35	2	2	0	2	1	0
8,301-10,000	21	2	2	0	3	2	0
10,001-13,000 +	27	2	1	1	3	3	0
13,001-15,000	21	1	1	0	1	2	0
15,001-18,000 +	8	1	2	0	0	1	1
18,001-24,000 +	14	0	0	0	1	2	0
24,001-31,000 +	5	0	0	0	0	0	0
Mbi 31,000	6	3	0	1	2	1	0
Te pa deklaruar	21	3	1	0	1	1	0
<b>Gjithsej</b>	<b>205</b>	<b>47</b>	<b>11</b>	<b>3</b>	<b>17</b>	<b>18</b>	<b>1</b>
<b>%</b>	<b>100</b>		<b>22.0</b>	<b>6.0</b>	<b>34.0</b>	<b>36.0</b>	<b>2.0</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

**IVIS: INTERVALET DUHET TE AXHUSTOHEN**

Nga totali i familjeve qe kane bere ndertime, pjesa me e madhe e tyre (49%) kane blere derrasa me nje sasi te pergjithshme prej 89m<sup>3</sup> dhe me nje çmim mesatar prej 10,029 leke/m<sup>3</sup>. Duke mbajtur parasysh faktin se vetem 23% te te intervistuarve u eshte dashur te perdorin lende druri (ndertime, rindertime, etj.) si dhe vellimin e pergjithshem te lendes se perdorur (156m<sup>3</sup>), nxjerrim se mesatarisht 3.3m<sup>3</sup> lende druri eshte perdorur per familje.

Ndersa lidhur me aspektin tjeter se sa m<sup>3</sup> lende druri per familje eshte siguruar nga pylli ne menyre ilegale, nuk mund te thuhet me saktesi per vete natyren e lendes se perdorur ne shumicen e rasteve. Derrasa, si zeri me i perdorur nga fshtaret, eshte fare e qarte qe nuk mund te merret direkt nga pylli, pasi kerkon nje faze paraprakisht perpunimi nga ajo çfare merret direct nga pylli dhe konsiderohet trup.

Edhe ne rastet ku te intervistuarit, te pyetur rreth burimit te sigurimit te tyre, jane pergjigjur direct nga pylli, kane nenkuptuar vendodhjen e sharrave dhe ngatrrave. Prandaj fakti qe eshte marre direct nga pylli nuk eshte e thene qe lenda te jete e siguruar nga pylli ne menyre ilegale.

Pasqyra 33. Lloji i lendes se perdorur, volumi dhe çmimi i blerjes

	% e familjeve qe kane blere keto zera	Vellimi (m <sup>3</sup> )	Nuk mbajne mend (%)	Çmimi mesatar (leke/m <sup>3</sup> )	Nuk mbajne mend (%)	Nuk ka paguar
Trupa	17.5	39	14.3	5,000	22.2	33.3
Lende ndertimi	14.0	19	23.8	11,000 <sup>14</sup>	22.2	16.7
Derrasa	49.1	89	33.3	10,029	16.7	16.7
Binare/Listela	19.3	9	28.6	5,250	38.9	33.3
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0</b>	<b>156</b>	<b>100.0</b>	<b>~ 7,820</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

**E PAKUPTUESHME si tabele???????????**

per te diskutuar me Prof.

Se fundmi, lidhur me arsyet e prerjeve ilegale, shumica e intervistuesve rendisin nevojat per perdorim vetjak (ngrohje, ndertim, etj.) si nje nga shkaqet e demtimeve ne pyje, kjo e llogaritur mbi parimin e mesatares. Ndersa si arsye e dyte fshtaret rradhisin nevojën per te fituar para e ndjekur nga kontrabanda e mire-organizuar dhe me interesa te medha tregtare ne pyje.

Pasqyra 34. Arsyet e Prerjeve Ilegale

<sup>14</sup> Shifra paraqitet e larte pasi ne disa raste me lende ndertimi te intervistuarit kane nenkuptuar derrasat.

Arsyet e prerjeve te paligjshme	N	Mesatarja	Deviacioni standard	Renditja sipas mesatares
Nevojat per perdorim vetjak (ngrohje, ndertim, etj.)	186	1.59	0.94	1
Nevoja per te fituar para	145	2.34	0.86	2
Pune per te trete	61	3.95	1.14	5
Kontrabande ne pyje e mire-organizuar me interesa te medha tregtare	102	2.37	1.20	3
Me shume mundesi fitimi per subjektet e perfshira ne aktivitetet e shfrytezimit	76	2.57	1.34	4

Burimi: Vrojtimi Social Ekonomik, QShKE, 2001

**E PAKUPTUESHME si tabele?????????**

**CFARE ESHTË N (mbase 205 intervistat). Ne rast se po atehere duhet te shprehesh me %. Cfare eshte mesatarja.**

**Bej lidhjen midis meanikng te eviacionit standart dhe luhatjeve ne vlerat e mesatares, jepi mesatares mbiemrin dhe thuaj nese kredibiliteti i ketyre konkluzioneve eshte i larte, i mesem, i ulet (bazuar mbi mesataren). A mund te gjindet dot koeficienti i sigurise ????????**

### 3. PRERJET ILEGALE NE NIVEL PARCELE: VLERESIM NE 450 EKONOMI PYJORE

#### 3.1. VLERESIMI I SISTEMIT TE MONITORIMIT TE DPPK-SE PER PRERJET ILEGALE

#### KETU DUHET PRAKTICITETI DHE JO PERSERITJE E PROPOZIMIT TEKNIK NE LIDHJE ME SUBJEKTIN

Per te vleresuar sistemin e monitorimit te prerjeve ilegale eshte e nevojshme kryerja e nje analize te detajuar rreth qendrueshmerise dhe vijushmerise midis informacionit qe grumbullohet, hedhjen e tij ne formulare analitike, periodicitetin e analizimit te informacionit te grumbulluar dhe raportimin e informacionit permbledhes ne instancat e tjera me te larta hirarkike; realizimit dhe qartesise ne detajimin e informacionit qe duhet te grumbullohet dhe pergatitjen e formulareve analitike perkates si dhe llojin e analizës statistikore qe kryhet; varetësisë horizontale dhe vertikale te stafit te DShP-ve te perfshira ne zbatimin e sistemit te monitorimit te prerjeve ilegale ne hierarkine institucionale te DPPK-se dhe shkallen e pergatitjes profesionale per zbatimin e ketij sistemi.

Per te identifikuar mosperputhjet e sistemit actual te monitorimit te prerjeve ilegale QShKE-ja realizoi tre studime te rastit<sup>15</sup> duke analizuar ne menyre te detajuar identifikimin dhe regjistrimin e te dhenave te prerjeve ilegale, dhe duke pare nese procesi i identifikimit dhe regjistrimit eshte ne vazhdimësi dhe nen vemendjen e perhershme te stafit te DShP-se perkatese (duke analizuar ne kete kuader metodologjine e punes, aftesite profesionale te stafit te DShP-ve te emeruar si inspektore zonash, sa jane te familjarizuar me sistemin e monitorimit ne fjale, korrespondencen midis vendbanimit dhe vetqendrimit te inspektoreve te zonave, etj.).

<sup>15</sup> U zgjodhen tre rrethe nga zona e studimit sipas vendodhjes gjeografike

#### 4. SHTOJCA: LEGJISLACIONI SHQIPTAR MBI PYJET: ANALIZA DHE PROSPEKTE

##### 4.1. STRATEGJIA QEVERTARE PER REDUKTIMIN E PRERJEVE TE PALIGJSHME KUADRI LIGJOR MBESHTETES, DHE DISA SUGJERIME PER PERMIRESIMIN E TIJ

###### 4.1.1 Prezantimi i Strategjise Qeveritare per Reduktimin e Prerjeve te Paligjshme

Problemi i prerjeve abuzive ka dale ne pah qe ne fillim te periudhes se tranzicionit social-ekonomik megjithese ne nivelet ne te cilat ndodhte ishin shume here me te ulta se keto te sotmet. Si rrjedhoje, gjate viteve te fundit te dhjetevjecarit te kaluar permasat e ketij fenomeni jane rritur shume duke e kthyer ate ne nje nder problemet kryesore per administraten pyjore dhe duke kompromentuar edhte rezultatet dhe arritjen e objektivave qe Qeveria shqiptare synon ne kuadrin e projektit Shqiptar te pyjeve.

Institucionet shqiptare duke ndare te njejtin shqetesim me donatoret persa i perket ketij fenomeni, permasave, tendencave dhe pa diskutim luften kunder tij, kane shprehur vullnetin e tyre per shmangjen e fenomenit ne fjale nepermjet ideimit dhe zhvillimit te hapave specifik si pjese e nje dokumenti me vete te quajtur Strategjia per Uljen e Nivelit te Prerjeve te Paligjshme. Kjo strategji eshte hartuar nga administrata pyjore shqiptare (DPPK) me mbeshtetjen e asistences teknike (FAO/004), dhe eshte miratuar nga Ministri i Bujqesise dhe Ushqimit. Kjo strategji e aprovuar, perfaqeson nje instrument ligjor po aq sa dhe nje metode per zhvillimin dhe implementimin e nje plan veprimi per uljen e shfrytezimit abusiv te pasurive pyjore kombetare.

Kjo strategji pershkruan hapat dhe askionet qe duhen te ndermerren per zhvillimin dhe implementimin e nje plan veprimi per uljen e prerjeve te abuzive dhe konsiston si me poshte:

- Ngritjen e nje Task - Force Nderministeriale te nivelit te larte;
- Permiresimin e autoritetit ligjor pergjegjes per prerjet e paligjshme duke perfshire edhe disa sugjerime per krijimin e nje Gjykate Pyjore Speciale;
- Permiresimi i mbeshtetjes dhe aftesive insituacionale ne nivel distrikti;
- Percaktimi i rajoneve pilot;
- Nje vleresim i pavarur per problemin e prerjeve te paligjshme nga nje pale e trete.

## 4.1.2 Ngritja e nje Task - Force Nderministeriale

### 4.1.2.1 Perberja dhe detyrat e Komisionit Task Force

Komisioni Task Force per Mbrojtjen e Pasurise Pyjore eshte krijuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 253 date 23.11.2000 "Per krijimin komisionit task force per mbrojtjen e pasurise pyjore".

Ky komision I kryesuar nga Ministri I Bujqesise dhe Ushqimit perbehet nga zyrtare te 11 institucioneve te ndryshme ministeriale apo qendrore si me poshte:

- Zevendesminister I Ekonomise Publike dhe Privatizimit,
- Zevendesminister I Pushtetit Lokal,
- Kryetari I Komitetit te Zhvillimit te Turizmit,
- Kryetari I Agjensise Kombetare te Mjedisit,
- Drejtori I Drejtorise se Pergjithshme te Pyjeve dhe Kullotave,
- Drejtori I Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit ne Ministrine e Rendit Publik,
- Drejtori I Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve ne Ministrine e Financave,
- Drejtori I Drejtorise se Policise se Ndertimit,
- Zevendesdrejtori I Drejtorise se Pergjithshme te Doganave ne Ministrine e Financave,
- Jurist I Kodifikimit ne Ministrine e Drejtesise

Gjithashtu jane ftuar te marre pjese ne cilesine e anetarit te komisionit, edhe drejtori i Drejtori i Drejtorise se Antikontrabandes ne Prokurorine e Pergjithshme.

Krijimi i ketij komisioni Task Force siguron **kuadrin politik** mbi te cilin do te mbeshtetet nje plan veprimi i detajuar dhe konkret per luften kunder prerjeve te paligjshme dhe duke qene I tille- shprehje e vullnetit politik te Qeverise shqiptare- sherben si sinjal i forte per te gjithë subjektet e perfshire ne aktivitetet e paligjshme ne pyje per mostolerimin e metejshem te ketyre aktiviteteve.

Komisioni Task Force eshte pergjegjes per pergatitjen dhe implementimin e **kuadrit ekzekutiv** perkates qe nenkupton hartimin "ne perputhje me programin politik te Keshillit te Ministrave te platformes per ndalimin e veprimtarise antiligjore per shfrytezimin e zonave pyjore si zenie te fondit pyjor per ndertime, prodhime inertesh ne keto zona si dhe rritjen e frytshmerise ne ndershkimin e kundravajtesve ne zonat pyjore dhe te nivelit te rritjes se vjeljes se detyrimeve qe rrjedhin nga keto kundravajtje".

Urdheri i kryeministrit per krijimin e ketij komisioni parashikon gjithashtu edhe **fushat kryesore** ku do te synojne masat e nevojshme per implemetimin e kesaj platforme:

- Bashkerendimi dhe angazhimi me I mire I institucioneve shteterore ne mbrojtje te pasurise pyjore
- Rishikimi I kateve ligjore ne fuqi per te mundesuar harmonizimin e tyre me legjislacionin pyjor
- Permiresimin e sistemit te monitorimit ne pyje

- Permirosimin e infrastruktures pyjore, rritjen e forces parandaluese dhe goditese ne sherbimin e Policise Pyjore

Kryetari i Komisionit Task Force duhet te raportoje prane Kryeministrit per ecurine e implementimit te ketyre detyrave. Bazuar ne Urdherin e mesiperm, Ministri I Bujqesise dhe Ushqimit me cilesine e kryetarit te ketij komisioni ka hartuar Platformen e Punes se Komisionit Qeveritar "Task Force" per Strategjine e Mbrojtjes se Pasurise Pyjore e Kullosores ku percaktohen drejtimet e punes se komisionit dhe nje Plan Veprimi per Mbrojtjen e Pasurise Pyjore ku percaktohen afate kohore per realizimin e detyrave te pershkruara ne platformen e punes se komisionit.

Bazat e funksionimit te ketij Komisioni jane **marreveshjet dypaleshe nderministeriale** te cilat do te rregullonin bashkepunimin dhe bashkerendimin e punes se ketyre ministrive.

Jane nenshkruar marreveshje te vecanta per bashkepunim nderdikasterial midis Ministrise se Bujqesise nga njera ane dhe Ministrise se Rendit Publik, Ministrise se Pushtetit Lokal, Drejtorise se Pergjithshme te Doganave dhe asaj te Tatimeve ne Ministrine e Financave, Drejtorise se Policise se Ndertimit ne Ministrine e Puneve Publike dhe Agjensise Kombetare te Mjedisit respektivisht.

#### 4.1.2.2 Komisioni Task-Force dhe Mangesite Ligjore: Disa rekomandimet perkatese

- Urdheri i Kryeministrit per krijimin e Komisionit Task - Force ashtu si dhe "Platforma e punes se Komisionit Qeveritar Task Force per strategjine e mbrojtjes se pasurise pyjore e kullosores dhe Plan Veprimi "Per mbrojtjen e pasurise pyjore" nuk parashikon afatet kohore te raportimit prane Kryeministrit. Vendosja e ketyre afateve do te perfaqesonte nje detyrim ligjor qe nga ana e vet do te rriste seriozitetin, impenjimin dhe do te sherbente si shtyese e metejshme ligjore per ecurine dhe zbatimin e ketij plan veprimi.
- Nuk jane respektuar afatet per rregullimin e ndryshimeve te nevojshme ligjore dhe nuk jane hartuar marreveshjet dypaleshe per zgjidhjen e mosperputhjeve mes ligjeve per mjedisin, ligjin e minierave , turizmin etj sic percaktohet ne pikat 3 dhe 7 te ketij plan veprimi.
- Marreveshjet nderministeriale, pervecse qe disa prej tyre duhet te rinenshkruhen ne rastet e nderrimit te personave me cilesine e nenshkruesis me qellim qe te vazhdojne te ngelen ne fuqi, ne asnje rast nuk shoqerohen me percaktimin e pergjegjesive dhe detyrimeve konkrete qe rrjedhin nga mospermbushja e angazhimeve si ndaj ligjeve perkatese ne fuqi ashtu dhe ndaj vete marreveshjeve te lidhura. Permbajta e marreveshjeve eshte shume e pergjithshme dhe percaktimi I veprimeve konkrete lihet ne cdo rast subjekt I marreveshjeve te tjera midis niveleve me te ulta institucionale. Keto marreveshje te tjera, qe per nga menyra si konceptohen -pasqyrim I veprimeve konkrete te paleve, do te perbenin pjesen me thelbesore dhe percaktuese per zbatimin e objektivave te strategjise dhe eficencen e saj nuk jane hartuar deri tani. Ne keto kushte, kuadri i nevojshem ligjor , percaktues per veprimet dhe mosveprimet e paleve, te drejtat dhe detyrimet lidhur me keto veprime apo mosveprime, nuk eshte I plote dhe fakti qe ketij kuadri I mungon pjesa me thelbesore dhe e rendesishme, e ben ate te paperdorshem dhe "nje strategji ne leter".

- Marreveshjet e lidhura midis Ministrise se Bujqesise dhe Ministrive apo drejtorive te tjera qendrore nuk duhen konceptuar vetem si marreveshje midis dy ministrive por si bashkerendim dhe kooperim I punes se dy administratave perkatese deri ne nivelet me te ulta te tyre dhe realizimi I detyrave qe percaktojne keto marreveshje duhet te konsiderohet si pjese integrale e detyrave funksionale te kesaj administrate.
- Duhet te rihartohen keto marreveshje duke perfshire ne te konsideratat e e mesiperme persa I takon percaktimit te te drejtave, detyrimeve , afateve etj duke qene keto marreveshje premisa baze per fillimin e funksionimit te punes se ketij Komisioni.

#### 4.1.3 Permiresimi i autoritetit ligjor per prerjet e paligjshme dhe disa konsiderata per ngritjen e nje Gjykate Pyjore

Strategjia per reduktimin e prerjeve te paligjshme parashikon si nje nder objektivat e saj permiresimin e autoritetit ligjor per prerjet e paligjshme dhe disa konsiderata per krijimin e nje Gjykate Pyjore. Sipas strategjise, DPPK duhet te identifikoje te metat dhe mangesite e legjislacionit aktual dhe te propozoje permiresimet e nevojshme te kuadrit ligjor ekzistues.

Kuadri ligjor ekzistues ka ne mjaft raste konflikte dhe mbivendosje kompetencash, te cilat jane objekt I shqyrtimit ne Kapitullin 2 te ketij materiali " Rishikimi I legjislacionit , rregulloreve dhe udhezimeve ne funksion te zbatimit te strategjise".

Permbledhtas mund te thuhet se ky objektivi tenton :

- rishikimin dhe shmangjen e aspekteve kontradiktore te disa legjislacioneve dhe kryesisht midis legjislacionit per mjedisin, turizmin, ligjin minerar nga njera ane dhe legjislacionit pyjor nga ana tjeter ;
- mundesite e permiresimit te legjislacionit kryesisht atij penal, te procedures penale dhe atij per kundravajtjet administrative persa I takon forcimit te autoritetit ligjor te policise pyjore dhe rendesise se veprave penale ne pyje;
- Parashikimin dhe perfshirjen ne kete kuader te mjeteve dhe instrumenteve ligjore qe do te favorizonin dhe ndihmonin imponimin e ligjit.

Sipas Plan Veprimit te Platformes se Komisionit Task Force , ky objektivi duhej te kish perfunduar deri ne Shkurt 2001, afat I cili nuk eshte respektuar.

(Persa I takon mbivendosjes konkrete te ligjeve dhe rekomandimeve perkatese shih kapitullin 2 .)

#### 4.1.4 Permiresimi i mbeshtetjes dhe aftesive insitucionale ne nivel distrikti

Nje tjeter drejtim I strategjise eshte dhe permiresimi I mbeshtetjes dhe aftesive institucionale ne nivel distrikti. Para se gjithash ketu kuptohet **sigurimi I mbeshtetjes logjistike** dhe asistences materiale per stafin e Drejtorive te Sherbimit Pyjor ne rrethe si radiokomunikacion, motorcikleta dhe pajisje te tjera te identifikuara nga DPPK dhe qe mendohen te kene nje impakt per reduktimin e prerjeve te paligjshme. Keto pajisje , me perjashtim te sistemit te radiokomunikimit I cili eshte ne fazen e tenderimit, jane siguruar nepermjet Projektit te Pyjeve.

Nje tjetër aspekt që do të shërbente mjaft rritjes së aftësive insitucionale të stafit të DSHP-ve do të ish dhe **trainimi dhe organizimi I seminareve trainuese të herpashershme** me qëllim njohjen me të mirë të ligjit dhe procedurave ligjore sidomos për policinë pyjore dhe rritjen e koordinimit.

Nje hap tjetër që do të shërbente fuqizimit dhe efikasitetit të punës së DSHP-ve do të ishte **prezantimi dhe përdorimi I nje sistemi monitorimi** nga ana e DSHP-ve për shmangjen e kundravajtjeve në pyje.

#### 4.1.5 Rajoni pilot

##### 4.1.5.1 Nevojat për ngritjen e Rajonit Pilot dhe objektivat e tij

Ideja e krijimit të Rajonit Pilot është hedhur duke pasur si qëllim zhvillimin e alternativave për reformën insitucionale (në kushtet kur objektivi I parashikuar për krijimin e korporatës pyjore dhe I mbështetur nga projekti shqiptar I pyjeve nuk pritet që të realizohet gjatë jetës së projektit dhe DPPK nuk ka një ide të qartë për zgjidhje insitucionale alternative) dhe dhenien prioritet të nevojave për harmonizimin insitucional dhe kuadrin ligjor .

Permbledhtas qëllimi i përgjithshëm i "Rajonit Pilot" është:

- Të testojë dhe të vlerësojë ndarjen e funksioneve komerciale nga ato të politikave,
- Të zhvillojë alternativa insitucionale dhe koncepte apo rregullime të menaxhimit të burimeve (sic është propozuar nën projektin e pyjeve dhe mbështetur nga *Strategjia për zhvillimin e sektorit pyjor kullësor në Shqipëri*);
- Zhvillimi dhe promovimi i koordinimit të metejshëm ndër-sektorial
- Në mënyrë specifike, zgjedhja dhe aplikimi I këtij rajoni pilot do të shërbejë për sa më poshtë:
- Projekti i Pyjeve do të pilotojë një zbatim të integruar të të gjithë aktiviteteve të projektit në një drejtori rajonale;
- Komponenti i zhvillimit insitucional duhet të fokusohet në ndarjen e aktiviteteve komerciale nga ato rregullatore të DPPK në një rajon të projektit (kjo mund të zbatohet nëpërmjet marrëveshjeve insitucionale në një bazë pilote, për replikimi i kesaj në nivel kombëtar do të kërkonte akte ligjore specifike).
- Ndarja e funksioneve komerciale nga ato të politikave do të testohet në një rajon pilot;
- Punët pyjore (rallimet dhe rehabilitimi i rrugëve ) të integrohen me zbatimin e planit të menaxhimit të pyjeve . Projekti duhet të fokusohet deri në zbatimin e pesë planeve , duke zgjedhur në fillim një vend brenda rajonit pilot.
- Zyrat pyjore në rreth, mbi një bazë pilote, të fillojnë marrëveshjet me fshataret për të siguruar shpërndarjen e drurit (fillimisht në 2 distrikte, preferohen në dy komuna model).
- Për të realizuar qëllimin e mesipër rajoi pilot duhet të kenë kërkesat specifike të mëposhtme:

#### 4.1.5.2 Mangesite ne statusin e Rajoni Pilot

Megjithese, DPPK dhe PMU kane caktuar vendosjen e rajonit pilot dhe objektivat e tij, deri tani nuk ka filluar realizimi I asnje prej aktiviteteve te propozuara dhe testeve te parashikuara. Nje nder arsytet qe kane shkaktuar kete, pervec vullnetit dhe impenjimit te dobet te paleve eshte dhe mospercaktimi ne asnje dokument ligjor i statusit juridik te ketij rajoni, duke filluar nga shtrirja gjeografike e tij dhe me pas me pershkrimin e aktiviteteve qe do te pilotohen, me percaktimin e detyrave, te drejtave dhe pergjegjesive te paleve ne permbushje te qellimeve per te cilat eshte ngritur ky rajon duke filluar nga niveli I DPPK dhe duke zbritur ne nivelin e DSHP-ve perkatese dhe qe perfaqesojne ndryshime jo te vogla nga statusi aktual qofte I DPPK dhe DSHP-ve si ne aspektin hierarkik ashtu dhe ate funksional.

#### 4.1.5.3 Rekomandime

Nisur nga mangesia e mesiperme ligjore, duhet qe me ane te nje Vendimi te Keshillit te Ministrave te percaktohet **statusi juridik** I rajonit pilot ku te gjejne pasqyrim te gjitha mangesite e permendura me siper dhe konkretisht:

- Perkufizimi si nocion I rajonit pilot she shtrirja gjeografike e tij
- Synimet qe kerkohen te arrihen nepermjet tij
- Aktivitetet qe do te zhvillohen ne permbushje te ketyre synimeve
- Te drejtat dhe pergjegjesite e paleve ne permbushje te ketyre aktiviteteve
- Afatet kohore te realizimit te ketyre aktiviteteve

### 4.2. KUADRI LIGJOR EKZISTUES DHE DISA KONSIDERATA PER HARMONIZIMIN E TIJ

#### 4.2.1 Kuadri ligjor ekzistues

Me poshte po paraqesim nje prezantim te permbledhur te kuadrit ligjor qe rregullon sektorin pyjor si dhe sektore te tjere relevante me te:

##### 4.2.1.1 Kushtetuta

Kushtetuta e re e miratuar ne **21 Tetor, 1998 (Ligji nr.8417)** persa I takon mjedisit dhe burimeve natyrore u jep te drejten njerezve per te informuar mbi gjendjen e mjedisit (neni 56). Ndermjet objektiveve te veprimtarise se shtetit ajo perfshin "nje mjedis ekologjik per brezat e tashem dhe te ardhem" dhe " nje shfrytezim racional te pyjeve ujit, kullotave dhe te gjitha burimeve te tjera natyrore ne baze te parimeve te zhvillimit" (neni 59).

##### 4.2.1.2 Qeverisja lokale

Organizimi dhe funksionimi i organeve te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise rregullohet nga ligji "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" Nr. 8652 Date 31.07.2000. Aktualisht jane 12 qarqe, te cilat jane njesi qeverisje te nivelit te dyte , te perbera nga disa komuna dhe bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa te perbashket. Nendarja e qarkut eshte rrethi.

Funksionet e qarkut jane ndertimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shteterore ne nivel qarku, si dhe cdo funksion tjetër i vet i dhene me ligj.

Komunat dhe bashkite ushtrojne funksione ne fushen e infrastruktures dhe sherbimeve publike, funksione me karakter social, kulturor dhe sportiv, dhe funksione ne fushen e zhvillimit ekonomik vendor ku nder te tjera "funksionin e pergatitjes se programeve te zhvillimit ekonomik vendor" dhe "ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore me karakter vendor".

#### 4.2.1.3 Kodi Penal

Vetem nje nen i **Kodit Penal** i kushtohet veprimtarive te kundraligjshme ndaj pyjeve: prerja apo demtimi i pyjeve pa qene i autorizuar ose ne zona te ndaluara ose ne periudha kohe eshte krim, i ndershkueshem me gjobe ose burgim deri ne nje vit. **Kodi i procedures penale** i jep policise gjyqesore drejten e arrestimit vetem ne raste krimesh te cilet jane te ndershkueshem me njeminimum prej 5 vjetesh burgim, keshtu qe kjo nuk aplikohet per krimet ndaj pyllit (sek. 30 dhe 32).

#### 4.2.1.4 Kundravajtjet administrative

Kundravajtjet administrative rregullohen nga ligji 7697 date 7.4.1993 "Per kundravajtjet administrative" I amenduar disa here me pas nga ligje te tjera. Nje nder keto amendamente, ligji 8343 i 1998 vendos qe kundravajtjet administrative ne rastet e mospagimit vullnetar te gjobave duhet te raportohen zyrtarisht tek autoritetet lokale ku kundravajtjesi ka vendbanimin ose kryen veprimtarine e tij.

#### 4.2.1.5 Ligji per Mjedisin

Ne 1991 u krijua "Komiteti per Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit" si nje departament qeveritar (per pak vjet brenda Ministrise se Shendetsise) me pergjegjesi per koordinimin e veprimeve qeveritare ne ceshtjet e Mjedisit. Komiteti me pas u kthye ne Agjensi Kombetare te Mjedisit i varur direkt nga Keshilli i Ministrave.

Ligji kryesor per mbrojtjen e mjedisit eshte **Ligji 7664 i 21 Janar 1993, "Per mbrojtjen mjedisore"** i modifikuar nga ligji 8364 dt. 2 Korrik 1998. Ky ligj eshte i lidhur me pylltarine sepse kerkon "licensa mjedisore" te nxjera nga autoritetet mjedisore per aktivitetet e listuara qe mund te kene ndikim mbi mjedisin (neni 17). Kjo perfshin nje game te gjere aktivitetesh sic jane ndertimi i infrastruktures, eksplorimi dhe shfrytezimi i tokave jeta e eger dhe peshkimi dhe ne lidhje me substancat e rrezikshme ne menyra te ndryshme. (neni 18).

Ne lidhje me pyjet, aktivitetet qe kerkojne licence jane: shfrytezimi i pyjeve qe kane interes te perbashket; krijimi i zonave te pyllezuara; gjuetia. (neni 18/6). Amendamenti i 1998 kerkon licence edhe ne rastet e ndryshimit te perdorimit te pyllit.

Ligji mbi mbrojtjen mjedisore kerkon gjithashtu edhe vleresimin e impakteve mjedisore, me kerkesen e autoriteteve mjedisore ose autoriteteve lokale (vecanerisht AKM, Agjensite Mjedisore te Keshillave Rajonale, Komunale, bashkiake dhe te Rrethit). Eshte

trajtuar dhe nje forme e pjesmarjes publike ne proces (kapitulli i dyte). Duke bere vleresimin e impakteve mjedisore do te ishte e domosdoshme marrja e licensave mjedisore. Jane pergatitur gjithashtu edhe rregulloret mbi vleresimin e impakteve mjedisore.

Parashikime te tjera te ligjit kerkojne zbatimin e marveshjeve nderkombetare mjedisore ne te cilat Shqiperia eshte pjese dhe pergjithesidht aderon me "norma dhe principe pergjithesisht te pranuar" te ligjit mjedisor nderkombetar, edhe pse te perfshira ne marveshje ne te cilat Shqiperia nuk eshte pale (neni 6). Tranzitet e lendeve te demshme nepermjet Shqiperise eshte i lejuar vetem ne qofte se ka nje mareveshje nderkombetare (neni 5). Ligji kerkon adaptimin e me teper rregullave specifike mbi ujin, ajrin, token, natyren, dhe mbrojtjen e tyre (neni 4).

Autoritetet mjedisore mund te pezullojne apo te nderpresin aktivitetet te cilat kane shkaktuar ndotje apo demtime mjedisore dhe te marrin masat perkatese (neni 31).

Ligji gjithashtu ka te beje dhe me politikat dhe ceshtjet institucionale, si formulimi dhe zbatimi i nje politike mjedisore dhe i nje strategjie mjedisore, adaptimi i standarteve mjedisore, pergatitja e nje raporti vjetor mbi gjendjen e mjedisit dhe shperndarjen e fondeve per kerkime.

Eshte krijuar nje inspektoriat per mbrojtjen e mjedisit qe i raporton AKM (neni 41). Keshillat komunale, bashkiake dhe te rretheve per adaptimin dhe publikimin e programeve te mbrojtjes se mjedisit, duke shperndare informacionin mjedisor dhe pergjithesisht duke kontrolluar situaten mjedisore (neni 42).

**Rregulloret mbi agjensite rajonale te mjedisit** u nxoren ne 1994 ne baze te ligjit mbi mbrojtjen mjedisore te 1993. Agjensite jane te bazuara ne prefektura. Funksionet e tyre perfshijne bashkepunimin per zbatimin e legjislacionit per mbrojtjen e mjedisit, mbledhjen e informacioneve te lidhura me mjedisin. Mbledhjen e gjobave ne baze te ligjit, kontrollin mbi menaxhimin e zonave te mbrojtura brenda juridiksioneve respektive, organizimin e vleresimeve te impakteve mjedisore te projektit, te cilat ne baze te ligjit per mbrojtjen e mjedisit, kualifikohen si "investime te karakterit lokal", dhe mbikqyrjen nga inspektoratet mjedisore.

#### 4.2.1.6 Ligji "Per Pyjet dhe Policine e Sherbimit Pyjor"

**Ligji nr. 7623, dt. 13 Tetor 1992, Per pyjet dhe policine e sherbimit pyjor, eshte ligji kryesor mbi pyjet.**

Neni 2 i ketij ligji ka te beje me perkufizimet e pronesise pyjore "toka pyjore" dhe "toka me bimesi pyjore" (te dyja respektivisht te perkufizuara ne nenin 3). Pyjet shtetore, komunale dhe private jane te gjitha pjese e konsiderueshme e kesaj pronesie. **Pyjet komunale**, nje kategori e re e shprehur nga ligji, jane tek tokat shtetore por perdoren per perdorim te perbashket te nje ose disa fshatrave ose komunave. Per menaxhimin e tyre duhen mareveshje ndermjet autoriteteve pyjore dhe atyre lokale. **Pyjet private** jane pyjet e gjetura ose te mbjella ne toka private (neni 4).

Ne pjese te ndryshme te ligjit jane percaktuar edhe **ndalime** (p.sh neni 9 mbi zenien dhe perdorimin e tokave pyjore pa autorizim, neni 26 per falsifikimin e markave, neni 34 per heqjen e disa pjesesh te bimeve apo specieve, nenet 47,48 per demtimin e instalimeve dhe firmimeve pyjore

**Funksionet e ndermarjeve pyjore te rrethit** jane percaktuar per te perfshire menaxhimin perhapjen dhe trajtimin shkencor te pemeve dhe drureve komerciale, dhe bimeve mjekesore ne pyjet dhe kullotat komunale. Druret e nje rendesie te vecante brenda apo jashte pronesise pyjore menaxhohen nga administrata pyjore (neni 11).

**Planit te menaxhimit** i referohet neni 15 :“planet e prodhimit dhe inventarizimit” duhet te pergatiten si per pyjet shtetore dhe per ato komunale por jo per pyjet private. Ka dhe referenca te tjera te rendesishme per menaxhimin ne pjese te tjera te ketij ligji. Ne vecanti neni 23 kerkon percaktimin e nje prerjeje te lejueshme e bazuar ne kriteret e perballueshmerise.

Mbrojtja e **pellgjeve ujembledhes** behet me ane te pyllzimeve dhe mbylljes se zonave per prerje dhe kullotje. Megjithate nuk eshte e thene qe keto te jene pergjegjesite e administrates te pyjeve.

Pergjegjesia per **peshkimin** ne ujrat malore i jepet administrates te pyjeve(neni 20).

“**Parqet pyjore nacionale**” dhe “rezervatet natyrore” mund te deklarohen nga Keshilli i Ministrave; rezerva shkencore, monumente natyrore, panorama, dhe drure industriale te mbrojtur mund te deklarohen nga Drejtoria. Drejtoria mund te nxjerre edhe rregullore per zonat e mbrojtura (neni 12). Mund te vendosen edhe tarifat e hyrjes.

Per mbledhjen e **produkteve te vogla te pyjeve** ku perfshihen gjethet dhe ushqimet e bagetive kerkohet gjithmone leje (nenet 33 dhe 35).

Ne baze te ligjit u krijua dhe policia e sherbimit pyjor. Ky sherbim eshte pjese e administrates pyjore por oficeret perfitojne statusin e ushtarakut dhe barazohen me ligj me punonjesit e rendit publik. (neni54-60).

Mbrojtja kunder zjarrit lidhet me nenin 43, i cili ndalon ndezjen e zjarreve qe mund te demtojne pyjet ose veprimet ne menyre te tille qe te mund te krijojne rrezik zjarri. Egziston detyrimi per te informuar mbi keto demtime dhe per te mare pjese ne fikje e zjarreve (neni 44).

Krahas legjislacionit kryesor ekziston gjithashtu edhe legjislacion ndihmes mbi insitucionet pyjore i cili do te shqyrtohen ne kapitujt e tjere te ketij materiali.

#### 4.2.1.7 Ligji mbi Turizmin

**Ligji nr.7665, i 21 1.1993 “Zonat prioritare te zhvillimit te turizmit”** I amenduar nga disa ligje me pas percakton strategjine se zhvillimit te turizmit e cila i propozohet Ministrise se Turizmit dhe miratohet nga Keshilli i Ministrave. Ne baze te strategjise pergatiten studimet e planeve urbane per identifikimin e zonave te pershtatshme per turizem. Komiteti I Zhvillimit te Turizmit aprovon aplikimet per aktivitetet e pershtatshme. Ai ka gjithashtu pushtetin per te vleresuar pershtatshmerina e aktiviteve jo vetem turistike ne zonat e pershtatshme dhe te nxjere vendime te bazuara ne aprovimin e Keshillit te Ministrave (neni.4).

Te ashtuquajturve persona te stimuluar ju jane dhene disa Garanci dhe Stimujt ne lidhje me perdorimin e te ardhurave apo kapitaleve dhe te perjashtimeve nga taxat (neni 6).

Ka edhe parashikime të tjera për investimet, kohezgjatjen dhe kushtet e marreveshjes së qerases së lidhur me personin e stimuluar për marrjen në dorezim të truallit së bashku me pasurinë e patundshme që ndodhen mbi të për ushtrimin e një veprimtarie të stimuluar (neni 7ç). Gjithashtu neni 10 I ligjit parashikon detyrimin e qiramarresit për mirembajtjen dhe riparimin e ndërtesave, rrugeve, ambienteve të tjera të shërbimit, zonave të gjelberimit etj gjatë kohezgjatjes së qerases, detyrim ky që I transferohet automatikisht çdo pasardhësi të qeramarresit.

#### 4.2.1.8 Ligji Minerar

Ligji Nr. 7796 datë 17.02.1994 parashikon ekskluzivitetin e ministrit për dhenien e të drejtave minerare, lejeve të kërkimit, të zbulimit dhe të shfrytëzimit dhe merr shumë pak në konsideratë pasojat e këtyre aktiviteteve mbi mjedisin. Vetëm një nen I këtij ligji, neni 95 parashikon detyrimin e subjektit mbajtës së lejes për të operuar në përputhje me rregullat për mbrojtjen e mjedisit dhe në rast dështimi të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit.

#### 4.2.2 Perplasjet e legjislacionit të fushave të ndryshme që lidhen me pylltarinë

**Legjislacioni kryesor mjedisor** (Ligji nr. 7664, i 21.1.1993 mbi Mbrojtjen e Mjedisit, dhe i amenduar nga ligji 8364 i 2.7.1998) kërkon një licencë nga autoritetet mjedisore për një numër aktivitete të lidhura me burimet natyrore. Kjo përfshin ndryshimin e përdorimit të tokave pyjore, shfrytëzimin e pyjeve që janë në interesin e përbashkët, krijimin e plantacioneve pyjore, gjuetinë etj. Këto parashikime krijojnë një sistem i cili është i papërshtatshëm dhe i vështirë për të zbatuar në praktikë. Pushteti i autoriteteve mjedisore dhe pyjore I përcaktuar nga ligjet përkatëse ka përplasje dhe mbivendosje. Kështu që të dy këto lloje autoritetesh duhet të pajisen me të njëjtën ekspertizë teknike me qëllim kryerjen e të njëjtave funksione. Për më tepër, personat private janë të detyruar nga parashikimet e mesipërme të marrin autorizime nga dy autoritete të ndryshme për të njëjtat aktivitete.

Për këto parashikimeve dalin edhe një sërë problemesh të tjera: për ndryshimet në përdorimin e tokës pyjore, ligji pyjor kërkon një aprovim nga Ministri për zonat nën 50 ha; dhe nga Këshilli i Ministrave për zona më të mëdha: nuk është e qartë nëse licenca e marrë nga autoritetet mjedisore mund të zëvendësojë një kërkesë të tillë. Vendosja se cilët pyje mund të konsiderohen si "të interesit të përbashkët" është akoma e paqartë.

**Ligji kryesor Minerar i Shqipërisë** (Ligji nr. 7796 i 17.2.1994 mbi Minerat) sic u sqarua më lart kërkon pak më shumë në konsideratë të interesave mjedisore dhe autoritetet në këtë kusht janë ekskluzivisht të autorizuar për nxjerrjen e të drejtave për zgjerimin e zonave të tokës (mbi 400 km<sup>2</sup>) pa ndonjë konsultim me autoritetet pyjore edhe pse pyjet mund të jenë tepër të ndryshuar.

dhe pse vendimi nëse të drejtat minerare duhet apo nuk duhet të jepen ngelen një mënyrë gjegjësi e plotë e autoriteteve minerare, përfshirja e autoriteteve pyjore do të ishte e përshkëlqyeshme për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të lidhura me aktivitetet minerare, me pikesynimin për të minimizuar ndikimin e tyre në pyje. Konsultimi me autoritetet pyjore do të ishte i kështillueshëm në fazën e ndryshme të zbatimit të ligjit, si përfshirja e lejeve të pritshme, kondicionet e eksplorimit dhe koncesionet minerare,

vecanerisht aty ku jane autorizuar teknika rebele; aprovimi i propozimeve per rehabilitimin e demtimeve te burimeve natyrore (neni. 45, iii); marja e masave urgjente per parandalimin e demtimeve mjedisore (neni. 95); aprovimi i kthimit te tokes ne gjendjen e saj natyrore pas perfundimit te te drejtave minerare qe aktualisht jepet nga Ministri I Minierave (neni . 99).

Per me teper cdo demtim ne pyjet shteterore ne lidhje me operacionet e shfrytezimit do te kompensohet (kjo eshte kerkuar vetem ne rastet e koncesioneve te minierave), dhe do te behet dhe nje pagese ndaj autoriteteve pyjore sipas legjislacionit pyjor per cdo lloj prerjeje.

Ne lidhje me **ligjin kryesor te turizmit** (ligji 7665 i 21 janarit 1993 "Mbi prioritetet e zhvillimit te zonave turistike dhe i amenduar nga ligji 8368 i 1998, dhe ligji 1609 i 1996 si dhe ligji 8163 i 1996) mangesia kryesore e verejtur eshte se autoritetet pyjore nuk jane te perfshire ne keshillin nderministror Keshilli i Politikave te Zhvillimit te Turizmit I cili miraton ose jo kerkesat e personit fizik apo juridik per dhenien e lejave per veprimtari te stimuluar apo vazhdimin e saj pra per te mare vendime ne lidhje me perdorimin e tokave per qellime turizmi, pra po keshtu dhe per tokat pyjore. Gjithashtu nje tjetër mangesi eshte se megjithese administrata pyjore vepron si perfaqesuese legale e Shtetit dmth si pronar i pronesise pyjore , ky keshill mund te hyje ne marveshje qeraje me palet e treta per token duke perfshire edhe ate pyjore.

Legjislacioni ne lidhje me zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin eshte pergatitur nga Agjensia Kombetare e Mjedisit, Meqenese Departamenti i Pyjeve dhe Kullotave mban disa pergjegjesi per menaxhimin e zonave te mbrojtura, do te ishte e rendesishme te kalohen konfliktet ndermjet roleve respektive te NEA dhe DGFP sic do te rezultojte nga legjislacioni i propozuar. Kontaktet midis dy institucioneve duhet te pranohen sa me shpejt te jete e mundur.

Me qellim qartesimin e rolit te institucioneve, ligji i ri duhet te siguroje rolin e pershtatshem per personat publike vecanerisht te lidhur ne deklarimin dhe menaxhimin e zonave te mbrojtura.

#### 4.2.3 Rekomandime per harmonizimin e legjislacionit

Bazuar ne mangesite e nenvizuara me siper rekomandohet qe te propozohen nga DPPK amendamente legjislative per te shmangur konfliktet ekzistuese midis ligjeve te siperpermendura, mbivendosjen e pushteteve apo lenien jashte te autoriteteve pyjore:

- Ne ligjin Minerar per te perfshire konsultimin me autoritetet pyjore ne faza te ndryshme te zbatimit te ligjit, si nxjerja e lejeve te pritshme, koncensionet e eksplorimit dhe koncesionet minerare, vecanerisht aty ku jane autorizuar teknika rebele; aprovimi i propozimeve per rehabilitimin e demtimeve te burimeve natyrore (neni. 45, iii); marja e masave urgjente per parandalimin e demtimeve mjedisore (neni. 95); aprovimi i kthimit te tokes ne gjendjen e saj natyrore pas perfundimit te te drejtave minerare qe aktualisht jepet nga Ministri I Minierave (neni . 99).
- Ne ligjin per Turizmin te parashikohet pjesemarrja e autoriteve pyjore ne Keshillin e Hartimit te Politikave dhe ligji te shrehet qarte mbi statusin e zonave qe perfshihen ne

fondin pyjor dhe ku kryhen aktivitetet e stimuluar nëse këto zona vazhdojnë të ngelen në administrim të DPPK apo jo.

